# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5573
E martë, 11 shtator 2018
çmimi 0.40 €


## Limaj thotë se po bëjnë përpjekje ta ofrojnë edhe opozitën në delegacion

FAQE 3




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", VISAR YMERI FAQE 4-5

# Nuk mund të ketë dialog pa konsensus



Nënkryetari i Partisë Socialdemokrate (PSD), Visar Ymeri, ka bërë me dije se nuk mund të ketë dialog me Serbinë pa konsensus politik e shoqëror. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se është e domosdoshme që Kuvendit të Kosovës t'i bartet vendimmarrja sa i përket dialogut në mënyrë që të parandalohen e të pamundësohen 'aventurat e rrezikshme të presidentit Thaçi' për territoret e sovranitetin e vendit. Ai ka theksuar se dialogu me Serbinë duhet të zhvillohet në kushte të transparencës së plotë dhe me pajtueshmërinë e të gjithëve për një platformë shtetërore sa iu përket qëllimeve dhe synimeve që i ka Kosova në këtë dialog. Ymeri ka thënë se vetëm pas votimit të një platforme shtetërore me votë të kualifikuar të 2/3 e deputetëve, procesi i dialogut do të fitonte legjitimitet dhe strategji

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, HASHIM THAÇI, KA PRITUR NË TAKIM PËRFAQËSUESIT POLITIKË TË LUGINËS SË PRESHEVËS FAQE 3

## Lugina e Preshevës kërkon rezolutë për bashkim me Kosovën

Liderët politikë të Luginës së Preshevës kanë kërkuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës miratimin e një rezolute përmes së cilës do të mbështetet kërkesa shumëvjeçare e shqiptarëve të Luginës për t'u bashkuar me Kosovën. Kjo kërkesë është prezantuar të hënën në një konferencë të përbashkët për medie, pas takimit të tyre me presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi. Përfaqësuesit politikë të shqiptarëve në Luginë i kanë bërë thirrje spektrit politik në Kosovë që të arrijë unitet në mënyrë që kërkesa e tyre të përkrahet nga të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës





## Shoqëria Lëvizja kërkon zbardhjen e vrasjeve të të burgosurve politikë

FAQE 7

## AKTUALE

### QEVERISJA HARADINAJ, FORCË SHTYTËSE E ZHVILLIMIT TË KOMUNAVE! F. 11



Besnik Tahiri

### POLITOLINGUISTIKA DHE FJALIMI POLITIK

F. 11



Hasan MUJAJ

### NEZIR ÇOÇAJ DORËZON MANDATIN E DEPUTETIT F. 2

### MATOSHI KËRKON PËRFSHIRJEN E BIK-ut NË AKSIONIN 'TA PASTROJMË KOSOVËN' F. 5

## EKONOMI



### PUNËTORËT E KEDS-it, SOT NË GREVË F. 9

### LLUKA PARALAJMËRON HAPJEN E MIJËRA VENDEVE TË PUNËS NË SEKTORIN MINERAR F. 8

## SPORT

### THEODORIDISI: FUTBOLLI I KOSOVËS DO TA KETË PËRKRAHJEN E UEFA-s F. 16

### RIKTHEHET SUPERLIGA, NESËR DERBI DRITA - LLAPI

F. 16


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## BE-ja reagon ndaj fjalimit të Vuçiqit për Millosheviqin



BRUKSEL, 10 SHTATOR - Bashkimi Evropian reagoi ndaj fjalimit të presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, në Kosovë, gjatë të cilit, Sllobodan Milloshevqin e cilësoi si "udhëheqës të madh, me qëllimet më të mira".
Maja Kocijançiq, zëdhënëse e BE-së e ngarkuar me çështjet e Ballkanit Perëndimor, tha se "nuk guxon të lihet hapësirë për dykuptimësi apo lavdërim" të atyre që kanë mbështetur politikën e Milloshevqit dhe veprimet e tij. "Vendimet e gjykatave vendase dhe ndërkombëtare në këtë drejtim janë shumë të qarta", tha Kocijançiq.
Ajo theksoi se të gjitha vendet në Ballkanin Perëndimor kanë perspektivë evropiane dhe për këtë arsye "do të duhet të jenë në përputhje me parimet e BE-së, përfshirë pajtimin dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore".
Vuçiqi ka qëndruar në Kosovë fundjavën e kaluar, ndërsa fjalimin e ka mbajtur në Mitrovicën e Veriut.

# Hoxhaj: Rusisë nuk i intereson kompromisi në mes të Kosovës dhe Serbisë

Sa i përket Rusisë, zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, tha se ky shtet nuk e ka interesin në kompromisin në mes të Kosovës dhe Serbisë, por dëshiron ta përdorë të njëjtin për t'i arritur kompromiset e veta jashtë Ballkanit



PRISHTINË, 10 SHTATOR - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, ka thënë se Federata Ruse nuk është e interesuar të arrihet kompromis në mes të Kosovës dhe Serbisë, por se interesi i saj është t'i arrijë kompromiset e veta jashtë Ballkanit.
Në një intervistë për "Der Standard", zëvendëskryeministri Hoxhaj deklaroi se Kosova dhe Serbia janë vetëm në fazën e parë të fazës finale të dialogut.
Ai tha se Kosova është e interesuar për arritjen e një marrëveshjeje që i hap rrugë anëtarësimit të vendit në Kombet e Bashkuara. "Kjo marrëveshje duhet nënshkruar në Bruksel, duhet të ratifikohet në dy parlamentet dhe të adaptohet në Këshillin e Sigurimit", tha zëvendëskryeministri Hoxhaj, transmeton "Ekonomia online".
Ai ka insistuar se Kosova do të mbetet shtet shumetnik dhe do të ekzistojë gjithmonë. Po ashtu, tha se marrëveshja me Serbinë i duhet Kosovës vetëm nëse ia siguron anëtarësimin në OKB. "Pikërisht për këtë është e rëndësishme të kihet parasysh se në çfarë mase mund ta zbatojnë një marrëveshje të tillë Bashkimi Evropian dhe Kombet e Bashkuara", tha ish-shefi i diplomacisë së Kosovës.
Hoxhaj tha se pakoja e Ahtisaarit ka dështuar së zbatuari në dy nivele. "Fillimisht, ka dështuar zhbërja e menjëhershme e strukturave paralele në veri të vendit. Së dyti, Kosova nuk është anëtarësuar në Kombet e Bashkuara. Dhe, të jemi të sinqertë, nuk kemi as shumë besim në Bashkimin Evropian, duke qenë se ende nuk kanë arritur t'i bindin pesë shtete të veta që ta njohin Kosovës, këtë dekadë që lamë pas. Pra, pse duhet t'i besojmë BE-së nëse mban një pozicion të tillë ndaj nesh", ka deklaruar ai për "Der Standard".
Sa i përket Rusisë, ai tha se ky shtet nuk e ka interesin në kompromisin mes Kosovës dhe Serbisë, por dëshiron ta përdorë të njëjtin për t'i arritur kompromiset e veta jashtë Ballkanit. Sidoqoftë, Hoxhaj tha se është herët të flitet për një përfundim të negociatave.

## Nezir Çoçaj dorëzon mandatin e deputetit



PRISHTINË, 10 SHTATOR (ER) - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Nezir Çoçaj, ka bërë me dije të hënën se ka dorëzuar mandatin e deputetit. Ai ka thënë se këtë vendim e ka marrë për arsye personale. "Njoftoj qytetarët se nga dita e sotme kam dorëzuar mandatin e deputetit. Arsyet janë personale (ka të bëjë me çështje profesionale). Po ashtu, falënderoj strukturat e partisë, anëtarët, përkrahësit dhe simpatizantët për mbështetjen e sinqertë të tyre. Shpresoj shumë që të mos kem zhgënjyer shumë nga ju! Por jam i sigurt se me qëllim dhe me vetëdije nuk kam dashur asnjëherë t'ju lëndoj me veprimet e mia, gjegjësisht me mosveprimet. Respekt të pafund për ju!", ka shkruar Çoçaj në llogarinë e vet në "Facebook".

## Kotzias: Së shpejti mbyllim negociatat me Shqipërinë

TIRANË, 10 SHTATOR - Nga Oslo, ku mori pjesë në takimin e Institutit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare të Norvegjisë për akademikët e politikanët e vendit, ministri i Jashtëm grek Nikos Kotzias e përqendroi fjalimin e tij te roli i Greqisë, si liderë në rajonin e Ballkanit dhe sfidat për ta përmirësuar bashkëjetesën me fqinjët, duke vendosur theksin te marrëdhënia me Shqipërinë dhe Maqedoninë.
E teksa diplomacinë greke e cilësoi "paqësore, me dinamikë inteligjente dhe pro dialogut", Kotzias nënvizoi se shumë shpejt do të finalizohet marrëveshja me Shqipërinë për detin dhe çështje të tjera bilaterale. "Përmes politikës proaktive të jashtme, ne jemi pranë zgjidhjes së problemeve të vjetra me Shqipërinë. Shumë shpejt, besoj, ne do t'i përfundojmë negociatat për një paketë me dhjetë çështje. Kjo paketë përfshin përcaktimin e kufijve dhe zonave detare, dhe kështu me radhë. Çështja është që këto probleme u krijuan dhe nuk u zgjidhën gjatë Luftës së Ftohtë. Shqipëria ishte nën regjimin izolacionist të Enver Hoxhës, kështu që nuk kishte shanse për të negociuar me të. Prandaj, mendimi ynë ishte dhe ende është që t'i zgjidhim këto çështje duke marrë iniciativa", tha Kotzias.
Ai theksoi se Greqia nuk është egocentrike dhe ia atribuoi vullnetit të vendit të tij për paqen, arritjen e "Marrëveshjes së Prespës" për emrin e ri të Maqedonisë. "Marrëveshja e Prespës nuk është as rezultat i rrethanave në Shkup apo në rajon, as rezultat i "presioneve të jashtme", siç u theksua shpesh nga partitë e opozitës në Greqi. Përkundrazi, ishte vetë zgjedhja jonë për të ndërmarrë një qasje proaktive, për të përcaktuar marrëdhëniet tona të jashtme në vetvete, jo që të përcaktohen nga të tjerët. Unë jam ministri i parë i Punëve të Jashtme greke që kam vizituar Maqedoninë e Veriut dhe në një konferencë shtypi, pas katër orë konsultimesh dhe para 400 gazetarëve u thashë atyre se ne e shohim vendin e tyre si "dhuratë e Perëndisë", por që ata kishin "Kumbarin" e gabuar", theksoi Kotzias.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur në takim përfaqësuesit politikë të Luginës së Preshevës

# Lugina e Preshevës kërkon rezolutë për bashkim me Kosovën

Liderët politikë të Luginës së Preshevës kanë kërkuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës miratimin e një rezolute përmes së cilës do të mbështetet kërkesa shumëvjeçare e shqiptarëve të Luginës për t'u bashkuar me Kosovën. Kjo kërkesë është prezantuar të hënën në një konferencë të përbashkët për medie, pas takimit të tyre me presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi. Përfaqësuesit politikë të shqiptarëve në Luginë i kanë bërë thirrje spektrit politik në Kosovë që të arrijnë unitet në mënyrë që kërkesa e tyre të përkrahet nga të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Përfaqësuesit e Luginës së Preshevës të hënën kanë kërkuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës që brenda një periudhe sa më të shkurtër kohore ta miratojë një rezolutë përmes së cilës do të përkrahet vullneti i shqiptarëve të Luginës për bashkim me shtetin e Kosovës. Këtë kërkesë liderët politikë të Kosovës Lindore e kanë prezantuar pas takimit me presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, në një konferencë të përbashkët për medie. Drafti i rezolutës është prezantuar nga kryetari i Komunës së Preshevës, Shqipërim Arifi.

Ai ka thënë se rezoluta do t'u dorëzohet të gjithë liderëve politikë në Kosovë, nga presidenti deri te kryetarët e partive politike. "Kërkesa kryesore është që Kuvendi i Kosovës ta miratojë një rezolutë për bashkimin e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit me Kosovën, duke u thirrur në vullnetin e shprehur të popullit shqiptar në Luginë në referendumin e 1 dhe 2 marsit të vitit 1992. Shpresojmë që sa më shpejt kjo rezolutë e nxjerrë nga liderët politikë të Luginës të procedohet në Kuvend", ka deklaruar Arifi.

Kërkesa e komunave Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, për bashkim me Kosovën, sipas Arifit, nuk ka të bëjë me shkëmbim të territoreve ndërmjet Kosovës e Serbisë, por me korrigjimin e kufirit të Kosovës. Ai ka thënë se përfshirja e Luginës në fazën finale të dialogut me Serbinë është kërkesë legjitime. Sipas Arifit, me këtë përfshirje do të krijohej një baraspeshë në dialog ngaqë në kuadër të delegacionit të Serbisë, përfshihen edhe përfaqësuesit e serbëve të Kosovës. "Është e domosdoshme përfshirja e Luginës së Preshevës në ekipin negociator të Kosovës i cili negocion edhe për Luginën në fazën finale të dialogut me Serbinë", ka theksuar ai, duke kërkuar edhe themelimin e Fondit Kombëtar të Solidaritetit për Luginën e Preshevës nga Kosova dhe Shqipëria.

Edhe kryetari i Komunës së Bujanocit, Shaip Kamberi, ka thënë se është e domosdoshme bashkëngjitja e Luginës së Preshevës me Kosovën. Për këtë çështje ai ka thënë se dialogu i Brukselit është një mekanizëm i cili duhet shfrytëzuar.

Ndërsa presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i ka dhënë edhe një herë mbështetje vullnetit të shqiptarëve të Luginës së Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit për t'iu bashkuar Kosovës. Po ashtu, ai ka mbështetur edhe përfshirjen e përfaqësuesve të këtyre komunave në



Presidentit të Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi
Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Kadri Veseli
Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj
Kryetarit të LDK-së, z. Isa Mustafa
Kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje, z. Albin Kurti
Kryetarit të PSD-së, z. Shpend Ahmeti
Kryetarit e Nismës Social-Demokrate, z. Fatmir Limaj
Kryetarit të AKR-së, z. Behgjet Pacolli
Kryetares së Alternativës Demokratike, znj. Mimoza Kusari
Kryetarëve të të gjitha grupeve parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Ne, liderët e shqiptarëve të Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës, ju drejtohemi me kërkesën që në një periudhë sa më të shkurtë kohore, ta miratoni një Rezolutë në Kuvendin e Kosovës, përmes të së cilës do ta përkrahni vullnetin tonë politik, të shprehur në Referendumin e 1 e 2 marsit 1992 për bashkimin e Preshevës, Bujanovcit e Medvegjës me Kosovën.

Prishtinë, 10 shtator 2018

Ragmi Mustafa
ARDITA SINANI
ARMEND ALIU

delegacionin e Kosovës në kuadër të dialogut me Serbinë. Sipas Thaçit, lënia e këtyre tri komunave brenda territorit të Serbisë ishte një padrejtësi historike që duhet të korrigjohet. Ai ka shprehur gatishmërinë e tij që në kuadër të dialogut dhe marrëveshjes paqësore me Serbinë të përfshihet edhe çështja e këtyre tri komunave dhe vullneti i qytetarëve të atjeshëm për t'iu bashkuar Kosovës. "Është momenti që të gjithë të ngrihemi mbi interesat personale dhe politike. Aktualisht Presheva, Medvegja dhe Bujanoci është një kauzë e përbashkët dhe mund ta realizojmë vetëm bashkërisht. Në kuadër të kësaj do të angazhohemi që edhe përfaqësuesit e Luginës së Preshevës të jenë pjesë e participimit jo vetëm përmes institucioneve të Kosovës, por edhe vetë personalisht në dialogun përfundimtar Kosovë - Serbi. Këtë besoj do ta përkrahin Qeveria, Kuvendi dhe të gjitha partitë në Kosovë", ka thënë Thaçi.

Ai ka ftuar Kuvendin, liderët politikë të Kosovës dhe partitë politike ta mbështesin angazhimin e tij që këto tri komuna t'i bashkohen Kosovës. "Për t'i kontribuar realizimit sa më shpejt për të drejtën e shqiptarëve të Luginës për bashkëngjitje me Kosovën natyrisht se duhet unitet edhe në Kosovë. Në kuadër të kësaj vetë përfaqësuesit e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit kanë propozuar një rezolutë e cila tash do t'i prezantohet kryetarit të Kuvendit, kryeministrit dhe partive politike", ka deklaruar ai, duke shtuar se tani mbetet që Kuvendi i Kosovës ta shqyrtojë dhe miratojë këtë rezolutë si mbështetje për aspiratat politike të përfaqësuesve të këtyre komunave për bashkim me Kosovën. "Inicimi i korrigjimit të kufirit të Kosovës me përfshirjen e këtyre tri komunave është çështje të cilën do ta shtrojë në tavolinën e bisedimeve, por nuk mund të garantojë askush se rezultati do të jetë përfshirja e Luginës në kuadër të territorit të Kosovës, por ia vlen të provohet. Kërkesën e tyre për bashkëngjitje me Kosovën jam i vendosur ta shtyj përpara", ka thënë ai. Thaçi është shprehur kundër që si kompromis me Serbinë, Kosova ta shkëmbejë pjesën veriore me këto tri komuna.

## Thaçi: S'mund ta vizitoj Preshevën, sepse jam i dënuar në mungesë nga Serbia

Përfaqësuesit e Luginës së Preshevës i kanë bërë ftesë presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, që ta vizitojë Preshevën sikurse që presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiqi, vizitoi Mitrovicën. Thaçi ka thënë se nuk mund ta vizitojë Luginën sepse është i dënuar në mungesë nga Serbia. "Përfaqësuesit e Preshevës dhe të Bujanovcit më ftuan ta vizitoj Preshevën. Por, Beogradi nuk po e sheh të arsyeshme që unë t'i vizitoj dhe nuk mund t'i vizitoj pasi që jam i dënuar. Nuk kam bërë ndonjë kërkesë ndonjëherë, pasi e di përgjigjen e tyre", ka theksuar Thaçi, duke shtuar se në kohët e vështira të Kosovës e ka vizituar Luginën e Preshevës pa lejen e Serbisë.

# Limaj thotë se po bëjnë përpjekje ta ofrojnë edhe opozitën në delegacion

PRISHTINË, 10 SHTATOR (ER) - Zëvendëskryeministri Fatmir Limaj ka pritur të hënën në takim ambasadoren e Finlandës në Kosovë, Pia Stjernvall, me të cilën ka biseduar për zhvillimet aktuale në vend, posaçërisht për fazën finale të dialogut me Serbinë. Me këtë rast, Limaj e ka njoftuar ambasadoren për formimin e delegacionit qeveritar për bisedimet me Serbinë si dhe për përpjekjet për t'ia ofruar mundësinë edhe opozitës që të jetë pjesë e këtij delegacioni, duke e shndërruar atë në delegacion shtetëror. "Pata kënaqësinë ta prisja në takim ambasadoren e Finlandës në Kosovë, Pia Stjernvall. Me ambasadoren biseduam për zhvillimet aktuale në vend, posaçërisht për fazën finale të dialogut me Serbinë. E njoftova ambasadoren për formimin e delegacionit qeveritar për bisedimet me Serbinë si dhe për përpjekjet tona për t'ia ofruar mundësinë edhe opozitës të



jetë pjesë e këtij delegacioni, duke e shndërruar atë në delegacion shtetëror", ka thënë Limaj pas takimit. Sipas Limajt, ambasadorja ka ofruar mbështetjen e shtetit finlandez për arritjen e marrëveshjes përfundimtare me Serbinë. "Marrëveshja përfundimtare me Serbinë për ne nënkupton njohjen e Kosovës nga Serbia si dhe anëtarësimin e Kosovës në OKB dhe organizma të tjerë ndërkombëtarë. E falënderova ambasadoren Stjernvall për mbështetjen e vazhdueshme që shteti finlandez po i jep Kosovës. Finlanda është shtet mik i Kosovës, e cila i ka ndihmuar Kosovës në të gjitha fazat", ka thënë Limaj.

Flet për "Epokën e re", Visar Ymeri

# Nuk mund të ketë d



**Nënkryetari i Partisë Socialdemokrate (PSD), Visar Ymeri, ka bërë me dije se nuk mund të ketë dialog me Serbinë pa konsensus politik e shoqëror. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se është e domosdoshme që Kuvendit të Kosovës t'i bartet vendimmarrja sa i përket dialogut në mënyrë që të parandalohen e të pamundësohen "aventurat e rrezikshme të presidentit Thaçi" për territoret e sovranitetin e vendit. Ai ka theksuar se dialogu me Serbinë duhet të zhvillohet në kushte të transparencës së plotë dhe me pajtueshmërinë e të gjithëve për një platformë shtetërore sa iu përket qëllimeve dhe synimeve që i ka Kosova në këtë dialog. Ymeri ka thënë se vetëm pas votimit të një platforme shtetërore me votë të kualifikuar të 2/3 e deputetëve, procesi i dialogut do të fitonte legjitimitet dhe strategji**

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Nënkryetari i Partisë Socialdemokrate (PSD), Visar Ymeri, ka ftuar subjektet politike për një konsensus nacional për fazën finale të dialogut me Serbinë. Ai ka thënë se konsensusi politik dhe shoqëror për dialogun është i domosdoshëm. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Ymeri ka bërë me dije se nuk mund të ketë dialog me Serbinë pa konsensus. "Konsensusi politik e shoqëror për dialogun është i domosdoshëm. Para se të flasim për mundësinë e arritjes së tij duhet ta themi qartë dhe troç: nuk mund të ketë dialog pa konsensus. Shteti ynë dhe shoqëria jonë e kanë shumë të rëndësishme që të debatojnë seriozisht për synimet tona politike, socio-ekonomike dhe pozicionin tonë rajonal. Ky lloj diskutimi është rruga drejt konsensusit që do ta forconte shumë pozicionin tonë në dialog. Para së gjithash, ne duhet të kemi projekt dhe vendosmëri për shtetndërtim në Republikën e Kosovës", ka thënë Ymeri.

Në lidhje me mungesën e vendimmarrjes në Kuvendin e Kosovës, ai ka thënë se kjo çështje shkon përtej numrave. Sipas nënkryetarit të PSD-së, dialogu me Serbinë duhet të zhvillohet në kushte të transparencës së plotë dhe me pajtueshmërinë e të gjithëve për një platformë shtetërore. "Është e domosdoshme që Kuvendit t'i bartet vendimmarrja sa i përket dialogut në mënyrë që të parandalohen e të pamundësohen aventurat e rrezikshme të presidentit Thaçi për territoret e sovranitetin e vendit. Dialogu me Serbinë duhet të zhvillohet në kushte të transparencës së plotë dhe me pajtueshmërinë e të gjithëve për një platformë shtetërore për sa iu përket qëllimeve dhe synimeve që i ka Kosova në këtë dialog", ka thënë ai, duke shtuar se shpërfillja dhe pamundësimi i vendimmarrjes në Kuvend që do të nënkuptonte sjellje e logjikë institucionale të politikëbërjes, e shndërron dialogun në mjet që u shërben interesave partikulare

# ialog pa konsensus



të Vuçiqit dhe Thaçit.
Ymeri ka folur edhe për bashkëpunimin e mundshëm opozitar që, sipas tij, ende nuk ka asgjë konkrete në këtë drejtim. "Nuk kemi parë asgjë konkrete në këtë drejtim. Nuk është shpallur ndonjë datë proteste nga askush. Vendimi për të qenë bashkorganizator apo për të marrë pjesë në çfarëdo proteste mund të merret vetëm kur dihen qëllimet dhe detajet e atij organizimi. Lidhur me bashkëpunimin që i referoheni, PSD-ja vlerëson se komentet për të duhet t'i japë partia që ka bërë një thirrje të tillë për njërën pjesë të opozitës. Ne vlerësojmë se kundër së keqes duhet bashkëpunim i gjithë opozitës, shoqërisë civile, pa u shpërfillur askush. Përndryshe, organizimet e tilla përfundojnë si partiake", ka thënë Ymeri.

**"Epoka e re":** *Z. Ymeri, Kuvendi i Kosovës ka ngecur në një situatë ku nuk po mund të marrë ndonjë vendim në lidhje me fazën finale të dialogut me Serbinë. As pozita dhe as opozita nuk e kanë shumicën e duhur. Çfarë mendimi keni ju për këtë situatë dhe PSD-ja?*
**Ymeri:** Kjo çështje shkon përtej numrave. Është e domosdoshme që Kuvendit t'i bartet vendimmarrja sa i përket dialogut në mënyrë që të parandalohen e të pamundësohen aventurat e rrezikshme të presidentit Thaçi për territoret e sovranitetin e vendit. Dialogu me Serbinë duhet të zhvillohet në kushte të transparencës së plotë dhe me pajtueshmërinë e të gjithëve për një platformë shtetërore për sa iu përket qëllimeve dhe synimeve që i ka Kosova në këtë dialog. Përndryshe, shpërfillja e pamundësimi i vendimmarrjes në Kuvend, që do të nënkuptonte sjellje e logjikë institucionale të politikëbërjes, e shndërron dialogun në mjet që u shërben interesave partikulare të Vuçiqit dhe Thaçit. Republika e Kosovës as nuk ka interes në këtë lloj të dialogut, e as nuk i ka borxh as Vuçiqit e as Thaçit.

**"Epoka e re":** *Cila mund të jetë zgjidhja për të lëvizur? Është i mundshëm një konsensus kombëtar për këto dy çështje?*
**Ymeri:** Konsensusi politik e shoqëror për dialogun është i domosdoshëm. Para se të flasim për mundësinë e arritjes së tij duhet ta themi qartë dhe troç: nuk mund të ketë dialog pa konsensus. Shteti ynë dhe shoqëria jonë e ka shumë të rëndësishme që të debatojë seriozisht për synimet tona politike, socio-ekonomike dhe pozicionin tonë rajonal. Ky lloj diskutimi është rruga drejt konsensusit që do ta forconte shumë pozicionin tonë në dialog. Para së gjithash, ne duhet të kemi projekt dhe vendosmëri për shtetndërtim në Republikën e Kosovës.

**"Epoka e re":** *Qeveria ka propozuar një ekip negociator për këtë fazë të dialogut. Si e keni parë këtë veprim të Qeverisë dhe pse nuk po i bashkëngjiteni këtij ekipi?*
**Ymeri:** Në Rezolutën e propozuar nga grupi parlamentar i PSD-së ne kemi ravijëzuar dhe sekuencuar procedurën vendimmarrëse që duhet ndjekur. Së pari vendimmarrja duhet t'i bartet Kuvendit. Pastaj Kuvendi duhet të diskutojë, përpilojë dhe miratojë platformën shtetërore me votë të kualifikuar (2/3 e deputetëve). Kështu, procesi i dialogut do të fitonte legjitimitet dhe strategji. Vetëm pas kësaj do të duhej të miratohej po me votë të kualifikuar përfaqësimi i Republikës së Kosovës në dialog, njëkohësisht mekanizmi mbikëqyrës karshi tij. Rendi i gjërave është i rëndësishëm. Nuk mund të flasim për kush para se të pajtohemi për çka.

**"Epoka e re":** *Pavarësisht prej zhvillimeve në Kuvend, presidenti Thaçi ka vazhduar takimet për dialog në Bruksel, ndonëse me presidentin serb nuk është takuar. Si mund të kufizohet presidenti në këtë drejtim?*
**Ymeri:** Për Kuvendin e Republikës nuk ka dialog me Serbinë. Ne në Kuvend ende nuk kemi miratuar kurrfarë dokumenti dhe nuk kemi mandatuar askënd që ta fillojë këtë dialog.

**"Epoka e re":** *Lëvizja Vetëvendosje ka përmendur protestat dhe bashkëpunimin me LDK-në si mundësi për ta penguar presidentin Thaçi. Do të jetë PSD-ja pjesë e protestave dhe këtij bashkëpunimi opozitar?*
**Ymeri:** Nuk kemi parë asgjë konkrete në këtë drejtim. Nuk është shpallur ndonjë datë proteste nga askush. Vendimi për të qenë bashkorganizator apo për të marrë pjesë në çfarëdo proteste mund të merret vetëm kur dihen qëllimet dhe detajet e atij organizimi. Lidhur me bashkëpunimin që i referoheni, PSD-ja vlerëson se komentet për të duhet t'i japë partia që ka bërë një thirrje të tillë për njërën pjesë të opozitës. Ne vlerësojmë se kundër së keqes duhet bashkëpunim i gjithë opozitës, i shoqërisë civile, pa u shpërfillur askush. Përndryshe, organizimet e tilla përfundojnë si partiake.

## Matoshi kërkon përfshirjen e BIK-ut në aksionin 'Ta pastrojmë Kosovën'

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 10 SHTATOR** - Ushtruesi i detyrës së ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, është takuar të hënën me kryetarin e Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiun Naim Tërnava, me ç'rast kanë biseduar për aksionin "Ta pastrojmë Kosovën" i cili fillon më 15 shtator 2018.
Gjatë këtij takimi ministri Matoshi ka kërkuar nga Myftiu Tërnava përfshirjen e BIK-ut në aksionin "Ta pastrojmë Kosovën", me qëllim të përmirësimit të mjedisit për qytetarët e Kosovës. "Pastërtia është gjysma e besimit, andaj duke u nisur nga kjo, sot jam ardhur këtu të kërkoj nga Bashkësia Islame e Kosovës të jetë pjesë e aksionit për pastrimin e vendit. Një tjetër synim që kemi dhe që duam mbështetje nga BIK-u është pastrimi i varrezave. Varrezat meritojnë trajtim më të mirë sepse aty janë njerëzit tanë, andaj është mirë të kemi një ndihmë edhe nga BIK-u", ka deklaruar Matoshi. Ai gjatë këtij takimi ka kërkuar nga përfaqësuesit e BIK-ut t'i kushtojnë një ligjëratë të veçantë rëndësisë së pastrimit të mjedisit. "BIK-u është institucion i respektuar, ka 800 xhami dhe në të gjitha xhamitë do të ketë thirrje për pastrim. Ne me BIK-un do të bashkëpunojmë në të gjitha fushat, mirëpo për këtë temë na bashkon pastërtia e vendit tonë", ka thënë Matoshi.
Ndërsa kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim Tërnava, ka falënderuar ministrin Matoshi duke premtuar mbështetje për aksionin "Ta pastrojmë Kosovën". "Bazuar në fenë tonë, islami kërkon që vendi dhe të gjithë të jemi të pastër. Po qe se e përkthejmë pastërtinë në term tjetër, ajo ka kuptimin e jetës. BIK-u në ditën e xhuma në të gjitha xhamitë do të mbajë ligjërata për ruajtjen e ambientit", ka thënë myftiu Tërnava.
Ministri Matoshi gjatë takimit me myftiun Tërnava ka treguar se në kuadër të aksionit për pastrimin e Kosovës, MMPH-ja ka ndarë grant prej 1.2 milion eurosh për komunat më të suksesshme në këtë aksion.
Rinia Demokratike e Kosovës (RDK) ka paralajmëruar se do t'i bashkohet aksionit për pastrimin e mjedisit në Kosovë. Do të jenë rreth 400 të rinj nga degët e RDK-së që do të angazhohen në këtë aksion.
Kryetari i RDK-së, Donjet Bislimi, ka theksuar se edhe pas këtij aksioni RDK-ja ka në plan aktivitete të ndryshme nëpër komunat e Kosovës me qëllim të sensibilizimit për shumë çështje dhe ndryshim të ambientit në të mirë të qytetarëve.
"Ta pastrojmë Kosovën" do të nisë më 15 shtator 2018, kurse do të përfundojë më 15 dhjetor.



# QKMF-ja e Rahovecit pranon donacion nga IPKO-ja në vlerë prej 5 000 eurosh

RAHOVEC, 10 SHTATOR (ER) - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) "Fahredin Hoti" në Rahovec ka pranuar një donacion nga IPKO në vlerë prej 5 000 eurosh. Në ceremoninë e dorëzimpranimit të këtij donacioni me aparatura për Repartin e Gjinekologjisë të pranishëm kanë qenë edhe kryetari i komunës, Smajl Latifi, me bashkëpunëtorë, Arianit Duraku, shef i shitjes në IPKO dhe stafi i QKMF-së. Gazmend Zeka, gjinekolog në QKMF-në e Rahovecit, ka thënë se aparaturat e pranuara si donacion nga IPKO-ja janë të nevojshme dhe do t'ia lehtësojnë punën personelit që punon në Repartin e Gjinekologjisë, por edhe nënave dhe fëmijëve që do të lindin në këtë qendër.





# Deçani nderon dëshmorët e kombit

DEÇAN, 10 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka bërë me dije se sot (e martë) do të përkujtohen dëshmorët e kësaj ane. Ai ka treguar se në orën 11:00, te Kompleksi Memorial në Gllogjan, do të përkujtohet dëshmori Xhevat Sejfijaj, ndërsa në orën 11:30 në fshatin Beleg do të bëhet zbulimi i bustit të dëshmorit të kombit Sadri Vishaj. Po në këtë ditë, në orën 12:00, në sallën e Asamblesë Komunale në Deçan do të shfaqet dokumentari "Në gjirin e bjeshkës sime" i autorit Islam Haxhiu.

# Asfaltohet rruga 'Gabrricë-Duraj' në Kaçanik



KAÇANIK, 10 SHTATOR (ER) - Në kuadër të realizimit të projekteve kapitale është asfaltuar rruga "Gabrricë-Duraj", investim ky i Komunës së Kaçanikut. Sipas menaxherit të projektit, Valmir Krasniqi, gjatësia e rrugës së asfaltuar është 995 metra, ndërsa gjerësia 5 metra. Sipas tij, kjo rrugë ka kushtuar 36 695 euro. Asfaltimi i kësaj rruge do të krijojë lidhje në mes të fshatrave Gabrricë-Bajnicë, njëkohësisht do të krijojë lehtësira qarkullimi për banorët e kësaj ane.



# Së shpejti pritet të fillojnë tri projekte të mëdha në Malishevë

MALISHEVË, 10 SHTATOR (ER) - Nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, ka bërë me dije se shumë shpejt pritet të fillojnë tri projekte të mëdha në këtë komunë. "Krahas fillimit të ndërtimit të rrugës së transitit për Malishevën, së shpejti pritet të fillojnë edhe tri projekte të mëdha. Shumë shpejt pritet të përfundojnë procedurat për ndërtimin e Qendrës së Banimit Social, pastaj rregullimi i shtratit të lumit Mirusha dhe ndërtimi i kanalizimit nga Lladrovci deri në Malishevë dhe lidhja e tij me kolektorin kryesor të ujërave të zeza", ka thënë Berisha.

Në mbledhjen e Këshillit të Drejtorëve është raportuar edhe për vazhdimin e projekteve kapitale dhe planifikimeve të tjera komunale. Po në këtë mbledhje është njoftuar edhe për përgatitjet për fillimin e aksionit të madh të pastrimit të ambientit, përkatësisht për largimin e deponive ilegale të mbeturinave, ku Drejtoria Komunale për Shërbimet Publike, së bashku me personat përgjegjës dhe nivelin qendror, do ta fillojnë këtë aksion në fund të javës.

Më 12 shtator do të mbahet edhe "Dita e Rinisë", ku janë paraparë të zhvillohen një varg aktivitetesh rinore.

# Bëhet zëvendësimi i dritave të ndriçimit publik në Prishtinë

PRISHTINË, 10 SHTATOR (ER) - Komuna e Prishtinës ka njoftuar se është duke bërë zëvendësimin e dritave të ndriçimit publik nëpërmjet energjisë së ripërtërishme. "Dritat e vjetra të ndriçimit publik po i zëvendësojmë me drita që funksionojnë përmes energjisë së ripërtërishme. Po kujdesemi që zgjerimi i mëtejshëm i rrjetit të ndriçimit publik të bëhet në të njëjtën formë", është thënë në njoftimin e Komunës së Prishtinës.



# Qeverisja Haradinaj, forcë shtytëse e zhvillimit të komunave




Besnik TAHIRI

Në një vit punë të qeverisë dhe gjashtë muaj në detyrën e Koordinatorit Nacional për Reformë Shtetërore, pavarësisht prej sfidave dhe vështirësive parë në retrospektivë, qeverisja e Ramush Haradinajt mund të vlerësohet për vendimmarrjen më efektive karshi reformave, me theks mbështetjes së komunave.

Në këtë periudhë janë pothuajse 50 vendime të drejtpërdrejta që lidhen me komunat. Këto vendime, para së gjithash, janë kërkesa të komunave për t'i adresuar nevojat e drejtpërdrejta të qytetarëve.

Kësaj radhe po shkruaj vetëm për raportin qeveri - komuna dhe një serë vendimesh që u kanë hapur rrugë bllokadave ndër vite me të cilat janë ballafaquar komunat, qoftë në rrafshin e legjislacionit, pronës, aspektit funksional apo financiar.

E nisëm me Prishtinën, për ta bërë pas dhjetë vjetësh me statusin e saj ligjor të kryeqytetit, për të vazhduar me mbështetje sektoriale, e për t'i prezantuar projektet e saj përballë partnerëve financiarë në mënyrë që t'i hapet perspektivë e re për funksionalitet dhe zhvillim.

Prishtina ishte pikënisje edhe për kthimin e pronave në shërbim të qytetit dhe qytetarëve, kështu bëmë me Pallatin e Rinisë, për të mos u ndalur, Prizrenin bashkë me partnerët dhe donatorët e kthyem në qendër të inovacionit dhe ngritjes së kapaciteteve. Po ashtu, i hapëm rrugë zhvillimit urban pas pothuajse një paralize të tërësishme. Qytetarëve të Obiliqit ua dhamë Ligjin që ua njeh sfidat që përballen për t'i dhënë dritë dhe zhvillim Kosovës.

Ndërkaq, në qytetin që gjithnjë po rritet dhe po urbanizohet, Fushë Kosovës, jemi në përfundim t'i ofrojmë zgjidhjen me ujë të pijshëm.

Kështu, vendim pas vendimi në vetëm një vit u hoqëm lakun komunave që u ishte vendosur ndër vite nga mungesa e vendimmarrjes dhe që po bllokonte zhvillimin e qëndrueshëm të tyre.

Por, këtë çështje nuk e lamë vetëm në vullnet vendimesh por e normuam në Projektligjin për Dhënien në Këmbim dhe Shfrytëzim të Pronës Komunale. Projektligj ky, që pronën publike e kthen në funksion të rritjes së potencialit ekonomik dhe zhvillimor.

Për më tepër, shtymë Ligjin për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje që u hap komunave një perspektivë të re të sanimit, të kaosit urban dhe trajtimit të këtij sektori për zhvillim dhe jetesë më të mirë të qytetarëve. Në këtë frymë, ishim në takime e vizita në komuna, ishim bashkë me vendimmarrësit dhe qytetarët, me partnerët dhe me një përfshirje të gjerë të të gjithë akterëve për t'u ofruar qytetarëve më shumë siguri për fëmijët në shkolla. Për të trajtuar rrezikun nga qentë endacakë e për t'iu gjendur atyre pranë në rastet e fatkeqësive, për t'ua zgjatur dorën kur mundi i tyre u rrezikua.

Përtej kësaj, projektet infrastrukturore po hapin shtigje dhe rrugë të reja që lidhin lagje, fshatra e qytete mes veti. Në fushën e ambientit, një çështje tejet sfiduese që po i japim zgjidhje për qytete e regjione është trajtimi i ujërave të zeza, problem ky jo vetëm ambiental, por edhe zhvillimor duke penguar bujqit, në shfrytëzimin e ujit për zhvillimin e produkteve të tyre.

Kemi nisur aksionin më të madh të pastrimit, moment ky që përmbyll një etapë të degradimit ambiental, e për të vendosur rregulla strikte për ruajtjen e ambientit. Kjo është vetëm tabloja e veprimeve direkte që janë ndërmarrë me komunat. Këtu nuk duhet harruar se pas një periudhe të gjatë krijuam rregullativën që trajton me dinjitet zyrtarin publik në të gjitha nivelet, duke tejkaluar një herë e përgjithmonë pabarazitë dhe për të ndërtuar një sistem unik qoftë në grada, qoftë në paga.

Për më tepër, pas kaq vitesh po stimulohet mekanizmi i kontrollit dhe mbikëqyrjes në komuna duke dhënë paga më të dinjitetshme për të zgjedhurit në kuvendet komunale. Ky mekanizëm është tejet i rëndësishëm për kontrollin, balancën dhe demokracinë në nivel lokal.

Jemi në fazën finale për të ofruar zgjidhje të qëndrueshme për ndërmarrjet publike qendrore dhe komunale, instrumente këto që i shërbejnë direkt qytetarit. Në këtë frymë jemi duke prodhuar një zgjidhje të qëndrueshme për inspektoratet në të gjitha nivelet, trupa këto që në shumë raste janë bërë pengesë për bizneset, e jo plotësisht funksionale për të vendosur rregull në fushat ku operojnë.

Tashmë jemi duke prodhuar zgjidhje për financimin e qëndrueshëm të komunave për t'i hapur mundësi të re atyre që buxhetet komunale t'i orientojnë në zhvillim të komunave për të vendosur më shumë autonomi, kritere për financim dhe disiplinë fiskale. Këtu po prodhohet edhe zgjidhja për zjarrfikësit që pas kaq vitesh paqartësish në financim dhe funksione po i kthejmë në mekanizma që i shërbejnë sigurisë dhe qytetarit duke iu kthyer para se gjithash dinjitetin në punë dhe në pagë.

Nuk duhet lënë të pa përmendur edhe sprovën që jemi duke kaluar për t'ia kthyer motivin sektorit të shëndetësisë në të gjitha nivelet. Kjo domosdo kërkon përpjekje edhe më të mëdha, qoftë në financim e po ashtu edhe hapësira, staf dhe pajisje. Këtu bashkë me shëndetësinë do të mbështesim edhe sektorin e arsimit primar dhe sekondar në nivel lokal, për ta trajtuar me legjislacion pasqyrën e vërtetë të problemeve dhe nevojave komunale, në mënyrë që kjo fushë të rregullohet njëherë e përgjithmonë. Po sigurohemi që të kemi financim të qëndrueshëm të kujdesit dhe shërbimit social, çështje kjo që na garanton kohezion në ecjen e përbashkët si vend dhe shoqëri.

Pa dyshim këto arritje janë sukseset e përbashkëta të komunave, qeverisë, akterëve të shoqërisë civile, mediave dhe përkrahjes së partnereve dhe donatorëve. Ne tashmë kemi ndërtuar një komunikim të vazhdueshëm dhe të strukturuar me komunat përmes forumit konsultativ 'Qeveri-Komuna'. Ky mekanizëm jo vetëm që do të shërbejë për të adresuar sfidat, por para së gjithash do të jetë një platformë e përbashkët për t'u dalë ballë kërkesave dhe nevojave të qytetarëve në secilën lagje dhe qytet të Kosovës.

Pa dyshim, ky proces ka edhe sfida që dalin qoftë me mbivendosjen e mekanizmave të vendimmarrjes, politikave ad-hoc, mungesën e standardeve në ofrimin e shërbimeve, apo mungesën e financimit, por pa dyshim se reforma strukturore së bashku me komunikimin e vazhdueshëm do të prodhojnë zgjidhje të qëndrueshme për funksionalitet që i hapë perspektivë të re zhvillimore komunave dhe adreson nevojat e qytetarëve.

Në këtë mes na duhen të shtohen përpjekjet e përbashkëta të shoqërisë civile, mediave, për të raportuar e korrigjuar problemet, na duhet shtuar komunikimi me bizneset, investitorët dhe diasporën për t'i dhënë frymë të re zhvillimit. Po ashtu, na duhet më shumë kontroll e transparencë mbi investimet publike, e po ashtu aq e rëndësishme është vendosja e rregullit dhe kontrollit në zbatimin e ligjit. Duke mos harruar këtu, në rend të parë, ruajtjen e jetës së njerëzve në punë, na duhet më shumë përfshirje e grupeve të margjinalizuara e po ashtu më shumë barazi e trajtim për gratë.

Këto nuk janë çështje të debateve të përplasjeve politike por, para së gjithash, përpjekje e përbashkët e shoqërisë për zhvillim dhe për arritjen e synimeve integruese.

## Shoqëria Lëvizja kërkon zbardhjen e vrasjeve të të burgosurve politikë

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Shoqëria Lëvizja ka dorëzuar të hënën 12 lëndë për hetim në Prokurorinë Speciale. Këto lëndë hetimi janë për vrasjen e gjashtëmbëdhjetë të burgosurve politikë të cilit ishin drejtues të Lëvizjes Popullore të Kosovës dhe Lëvizjes Kombëtare.

Xhevat Bislimi, kryetar i Shoqërisë Lëvizja, ka thënë se këto lëndë u dërguan për t'u hetuar vrasja e veprimtarëve të lëvizjeve popullore, në mesin e të cilëve janë emrat e Kadri Zekës, vëllezërve Gërvalla, Ukshin Hoti etj.

Bislmi ka njoftuar se ndërkohë do të dorëzojnë dhjetëra lëndë të tjera për vrasjen e të burgosurve politikë. Ai ka thënë se shpreson që prokuroria t'i hetojë këto raste, në mënyrë që shoqëria ta ketë ndërgjegjen e qetë dhe populli të dijë për fatin e tyre.

Edhe Bajram Ajeti nga Shoqëria Lëvizja ka thënë se është detyrë e prokurorisë t'i ndriçojë rastet dhe të zbardhen ato. Ai ka shtuar se mbase përgjegjësit për këto raste sot po shëtiten të lirë, por ka thënë se sot nuk do të përmendë emra.

Në këto lëndë hetimi që janë dërguar sot janë rastet e 16 të burgosurve politikë.



# Lluka paralajmëron hapjen e mijëra vendeve të punës në sektorin minerar

PRISHTINË, 10 SHTATOR (ER) - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka thënë se janë duke shtuar përpjekjet për zhvillim të sektorit minerar në Kosovë, përfshirë zhvillimin e Trepçës, që do të thotë se në vitet e ardhshme do të hapen mijëra vende pune në këta sektorë. Përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se së shpejti do të dalë me disa hapa konkretë për ta rritur interesimin e të rinjve që t'i ndjekin këto trajnime dhe të certifikohen. "Javën që shkoj isha për vizitë në Qendrën e Trajnimeve në Korporatën Energjetike të Kosovës. Kjo vizitë ishte sa dëshpëruese, aq edhe inkurajuese. Dëshpëruese për faktin se kjo qendër është e pajisur jashtëzakonisht mirë, me teknologji moderne dhe me trajner me përvojë dhe certifikime ndërkombëtare, mirëpo nuk shfrytëzohen aspak kapacitetet trajnuese pasi edhe nuk ka interesim të mjaftueshëm. Inkurajuese për faktin se ka potencial fantastik për të prodhuar ekspertë të certifikuar, të njohur ndërkombëtarisht në fusha të ndryshme për industritë e energjisë, përpunimit të metalit dhe minierave. Në fillim të këtij viti kemi aprovuar strategjinë për energji që parasheh investime rreth tre miliardë euro, përfshirë ndërtimin e Termocentralit Kosova e Re", ka shkruar Lluka, duke shtuar se janë duke shtuar përpjekjet për zhvillim të sektorit minerar në Kosovë, përfshirë zhvillimin e "Trepçë"-s. "Kjo do të thotë se në vitet në vijim do të hapen mijëra vende pune në këta sektorë dhe është shumë me rëndësi që mos të vijë momenti kur importojmë fuqi punëtore me këto shkathtësi", ka shkruar Lluka.



# Pakoja e projektligjeve për paga diskutohet të mërkurën



PRISHTINË, 10 SHTATOR (ER) - Komisioni Parlamentar për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie, ka mbajtur të hënën mbledhje, në të cilën është shqyrtuar plani i punës për sesionin vjeshtor. Këtë plan para anëtarëve e ka prezantuar kryetari i këtij komisioni, Nait Hasani. "Në rend dite e kemi përcjell agjendën e projektligjeve, ku përfshihen projektligjet që na kanë mbetur. Ministri i Administratës ka thirrur në takim për ta shqyrtuar paketën e ligjeve të administratës. Ata e kanë ndarë nivelin e pagave për të gjitha kategoritë", ka thënë Hasani.

Shqipe Pantina, nënkryetare e këtij komisioni, ka propozuar që në Projektligjin për mbrojtjen e të dhënave personale të punojnë bashkë me Komisionin për Siguri. Ndërkaq për të mërkurën është paralajmëruar takimi me Ministrinë e Administratës Publike për ta diskutuar pakon e projektligjeve për paga.

# BQK-ja merr mbështetje nga Thesari Rajonal i Ambasadës Franceze në Sofje

PRISHTINË, 10 SHTATOR (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovë (BQK), Fehmi Mehmeti, ka pritur në takim drejtorin aktual të Thesarit Rajonal të Ambasadës së Francës në Sofje, Jean Marie Demange, drejtoreshën në ardhje, Florence Dobelle dhe Joseph Giustiniani, atashe për bashkëpunim në Ambasadën e Francës në Kosovë, me të cilët ka diskutuar për zhvillimet e fundit në sektorin financiar, veçanërisht në atë bankar. Mehmeti i ka njoftuar të pranishmit se sektori bankar vazhdon të ketë performancë të mirë dhe shkallë të lartë të qëndrueshmërisë dhe se zhvillimet pozitive po ndikojnë edhe në rritjen e aktivitetit të tyre në mbështetje të zhvillimit ekonomik. Ndërsa drejtuesit e Thesarit Rajonal të Ambasadës së Francës në Sofje kanë shprehur gatishmërinë për të bashkëpunuar ngushtë me Bankën Qendrore të Kosovës me qëllim të mbështetjes së zhvillimit ekonomik të vendit.



# Punëtorët e KEDS-it, sot në grevë



Sot (e martë) nga ora 8:30 deri në orën 16:30 punëtorët e KEDS-it do të protestojnë në shenjë pakënaqësie ndaj shkeljes së të drejtave të tyre nga kjo kompani. Përfaqësuesit e Federatës së Sindikatave të Pavarura "Elektrokosova" kanë paralajmëruar grevë të përgjithshme në rast se menaxhmenti i kësaj kompanie s'do t'i përfillë kërkesat e tyre

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Përfaqësuesit e Federatës së Sindikatave të Pavarura "Elektrokosova" në një konferencë për medie të hënën kanë folur rreth grevës së punëtorëve të KEDS-it, e cila do të mbahet sot (e martë) nga ora 8:30 deri në orën 16:30. Ata kanë bërë me dije se gjendja në KEDS është shumë e rëndë që nga privatizimi ku, sipas tyre, punëtorët në këtë kompani janë duke u nëpërkëmbur.

Kryetari i Këshillit Grevist, Fehmi Pajaziti, ka thënë se kanë ardhur në një gjendje që të hyjnë në grevë për shkak të moszbatimit të kontratës kolektive dhe mosarritjes së pagës për 150 euro. "Nëse nuk ka zbatim të kërkesave do të shkojmë në grevë të përgjithshme që nënkupton kolaps energjetik. ZRrE-ja merr vendim që në kuadër të hyrave të lejuara t'i ketë parasysh kërkesat tona. Lus deputetët që të kenë parasysh edhe kërkesën tonë", ka thënë Pajaziti. Sipas tij, janë 2 200 punëtorë që janë duke kërkuar rritje pagash për 150 euro mbi pagën bazë.

Kurse Hysni Gashi, kryetari i FSPE-së, ka theksuar se që nga privatizimi KEDS-i është duke nëpërkëmbur punëtorët dhe kërkesat e tyre. Ai ka thënë se në rast se nuk do të plotësohen kërkesat e tyre do të hyjnë në grevë të përgjithshme. "Ne edhe më parë e kemi informuar opinionin se gjendja në KEDS është shumë e rëndë. Tani nga privatizimi është duke u bërë një nëpërkëmbje ndaj punëtorëve të KEDS-it. Menaxhmenti i KEDS-it nuk ka reflektuar ende. Ne vendosem të fillojmë grevë që nga nesër. Prej orës 8:30 deri në orën 16:30 nuk do të ketë shërbime nga punëtorët grevistë dhe të gjithë do të vijnë në Prishtinë", ka thënë Gashi.

# Hamza: Austria, partnere strategjike e Kosovës



PRISHTINË, 10 SHTATOR (ER) - Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka pritur të hënën në takim ambasadorin austriak në Prishtinë, Gernot Pfandler, dhe udhëheqësen e Odës Ekonomike Austriake në Kosovë, Vjosa Huruglica, me të cilët ka diskutuar lidhur me zhvillimet e fundit në Ministrinë e Financave si dhe në përgjithësi për fushën e financave në Kosovë. Me këtë rast, ministri Hamza e ka njoftuar ambasadorin Gernot Pfandler për masat që ka marrë Qeveria e Kosovës për ndryshimin e ligjeve të cilat mundësojnë dhe ndikojnë në krijimin e kushteve më të mira në të bërit biznes, me theks të veçantë për sektorin e prodhimtarisë, si dhe e ka njoftuar atë për të arriturat dhe aktivitetet e tjera që janë zhvilluar gjatë këtij viti në Ministrinë e Financave.

Ministri Hamza ka falënderuar ambasadorin austriak për mbështetjen e shtetit të Austrisë ndaj Kosovës dhe ka shprehur gatishmërinë e tij si ministër i Financave për vazhdimin dhe thellimin e mëtutjeshëm të bashkëpunimit ndërinstitucional.

Ndërsa ambasadori austriak Gernot Pfandler e ka falënderuar ministrin Hamza për bashkëpunimin, në të njëjtën kohë ka shprehur gatishmërinë e shtetit austriak për mbështetjen edhe në të ardhmen të institucioneve të Kosovës për rritjen e bashkëpunimit në aspektin ekonomik dhe politik.

# Politolinguistika dhe

Një numër i madh i "politikanëve" të sotëm të Kosovës, nga njerëz të papunë, pa profesion, përmes shpërdorimesh të ndryshme, kanë kërcyer në tarracën më të lartë politike pa kaluar, së paku, ndonjë shkallë të ngritjes e të përvojës dhe janë bërë: kryeministra, ministra, zëvendësministra, deputetë etj. Dmth. ministritë janë shndërruar në ente të papunësisë! Kjo është e vërteta e politikës së Kosovës sot



Hasan MUJAJ

Nga fjalimet e diskutimet e shumë qeveritarëve të lartë të shtetit mund të kuptohet se shumë oratorë, politikanë e qeveritarë të Kosovës ende nuk dinë se ka shumë kohë që në disa shtete të Perëndimit është themeluar një disiplinë e re shkencore e quajtur politolinguistikë. Kjo shkencë është më se e mbëhishme (e nevojshme) për t'u mësuar nga secili që do të merret me politikë. Politolinguistika është themeli i fjalimit politik. Pasi është kështu, vështruar nga këndi i krahasimit të barazisë, mund të thuhet se aq sa mund të ngrihet ndërtesa pa themel të qëndrueshëm, aq mund të konstruktohet me kompetencë fjalimi politik pa politolinguistikë.

Politolinguistika është disiplinë shkencore e gjuhësisë, e cila ndjek hulumtimin shkencor të komunikimit politik. Ajo është disiplinë empirike e linguistikës aplikative; ajo kap disa fusha të gjuhësisë ndër të cilat vendin kryesor e zënë semantika dhe pragmalinguistika. Në vitin 1996, me studiuesin Armin Burkhardt në krye, politolinguistika sa vinte e po merrte shtrirje të gjerë zhvillimi si analizë kritike e gjuhës politike dhe, si shkencë dyjare, u vendos midis linguistikës e politologjisë. Në Universitetin e Vjenës u themelua një sektor i veçantë i studimit të saj. Si objekt studimi politolinguistika ka ndërtimin dhe përzgjedhjen e shprehjes politike në të gjithë përbërësit e saj p.sh. fjalori politik, i cili kërkon pasuri dhe freski të përhershme, gjuha parlamentare dhe sociokultura, strategjia politike e komunikimit sipas rrethanave politike, metaforika e politikës dhe pyetjet retorike, dialogu politik, polisemia dhe variantet mikrosemantike, eufemizmi politik, të cilin Burkhardt e sheh si element të rëndësishëm të gjuhës politike, të cilën (gjuhë) e bën më të depërtueshme dhe më të pranueshme, biheviorizmi politik, kontestet dhe marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat gabojnë shpesh politikanët e Kosovës dhe gabimet i shohin pasi t'i nënshkruajnë; më pas provojnë t'i shfuqizojnë dhe dëshmojnë se nuk dinë ç'janë politolinguistika, filozofia politike, filozofia morale etj.

Kritika politolinguistike është mjaft komplekse; ajo i tejkalon caqet linguistike dhe bashkërendohet me shkenca të tjera jogjuhësore, integrimi i të cilave ngre lart stilin politik, e avancon atë dhe e favorizon akseptimin politik të tij.

Praktika e përditshme e komunikimit politik dëshmon se në veprimtarinë politike të shumë zyrtarëve të lartë të Kosovës nuk zhvillohet diskutim sipas kritereve të shkencave politike, pra as sipas politolinguistikës; në Kosovë si politolinguistikë shërbejnë: mashtrimi, gërnja, montimi, trillimi, kërcënimet me sulmet fizike dhe cili politikan do të dalë fitues në rrahje (Konjufca), kush nga vjen: prejardhja e politikanit (si irelevante që është), mbiemri, martesa, përfitimi, pozitat e larta pa përgatitje e pa përvojë të njerëzve anonimë, interesi i partive politike dhe i individëve për favore të ndryshme dhe më së paku ndiqet përkushtimi i forcimit dhe i zhvillimit të shtetit etj. Kështu, pra, duket politolinguistika sot në Kosovë!

Njohja e statusit fals të disa mijëra "veteranëve" përmes korrupsionit, tentativa për t'i shfuqizuar marrëveshjet e nënshkruara ndërkombëtare madje ndonjë edhe të ratifikuar në Parlamentin e shtetit (Gjykata Speciale e Hagës), lejimi i kidnapimit të shtetasve turq, dyfishimi i pagave të qeveritarëve, mosngritja e aktakuzave ndaj disa zyrtarëve të lartë për afera korruptive, për shpërdorime të ndryshme, për falsifikime në arsimin e lartë e vepra të tjera penale, janë disa tregues faktikë të moszbatimit të ligjit dhe të një gjendjeje anarkike, e cila, sidomos vitet e fundit, e ka komprometuar vendin në relacionet ndërkombëtare si shtet jofunksional. Së këndejmi, s'është habi që nuk ka njohje të reja të shtetit, që nuk ka investime të jashtme kapitale si rrjedhojë e korrupsionit të lartë, që nuk hetohet prejardhja e pasurisë enorme e disa politikanëve etj.

Politolinguistika duhet të studiohet e të zhvillohet edhe në pragmatikën politike të Kosovës. Ajo, siç shihet edhe nga termi i emërtimit, burimin e materies e ka në dy fusha kryesore: në politikë dhe në linguistikë, në të cilat qëndron lënda nga mund të kapen edhe temat e ndryshme të trajtimit, edhe mjetet e pasqyrimit e të zbërthimit të tyre. Në kontekstin politik, këto dy dije duhet të shihen të integruara për të ndërtuar tekst me efikasitet të ndikimit dhe të edukimit politik.

Zgjedhja e fjalëve politikisht të matura kërkon njohuri të thella të oratorit jo vetëm rreth temës në trajtim, por edhe nga shkencat e komunikimit. Aspekti politik i fjalimit ndjek strategjinë e depërtimit të pranueshëm dhe realisht të zbatueshëm kurse komponenti linguistik i fjalimit qëndron në dispozicion të politikës për të ofruar mjete të përshtatshme ndërtimi e parashtrimi të mendimit politik.

Politikani duhet të zgjedhë stilin politik në përshtatje me temën përkatëse me fjalë e shprehje, semantika e të cilave është korresponduese me strategjinë politikisht sa më të pranueshme, me ecurinë që nuk mbyll shtegun e trajtimit e të hulumtimit të modaliteteve praktike gjithnjë të mbështetura në parimet e së drejtës dhe të realitetit.

## Fjala, forcë e politikës

Filozofi amerikan i shkollës pragmatike të Çikagos Xhon Pirsi, rreth aftësisë oratorike në fushën politike e diplomatike, rreth zgjedhjes së njësive gjuhësore në komunikimin politik, shkruan: "Diplomacia është art: me njëqind fjalë nuk mund të thuhet çka mund të thuhet me një fjalë".

Nga ky citat del e kuptueshme se ç'domethënie ka fjala, sidomos në kuptimin politik; zgjedhja e fjalës dhe futja e saj në kontekstin e strategjisë efektive duhen të mbështeten në filozofinë e reflektimit politik dhe në semantikën e kompetencës retorike e stilistike. Prandaj, oratori, me njohuri të gjera të shkencave të komunikimit, duke e përqendruar vëmendjen për t'i zgjedhur njësitë gjuhësore nga pikëpamja denotative dhe konotative, përmbajtja e të cilave është e zbatueshme, do të jetë i pranueshëm dhe praktik në fjalimin politik.

Përkitazi me rëndësinë dhe me ndikimin e fjalës në politikë, studiuesi Georg Klaus shkruan: "...das Wort ist ein machtiges Instrument der Politik".' Dmth. "...Fjala është instrumenti më i fuqishëm i politikës" (Armind Burkhardt, "Das Parlament und seine Sprache", Tubingen, 2003, f. 117)

Është detyrë dhe zotësi e oratorit që ta njohë sa më gjerësisht materien leksikore, stilistike, sintaksore, frazeologjike etj. të gjuhës që përdor dhe të dijë të zgjedhë ''material ndërtimor'' (njësitë gjuhësore) përkatës sipas motivit e qëllimit nga aspektet e filozofisë morale dhe të filozofisë politike për ta bërë ndërtimin e tekstit sipas kritereve të arkitekturës retorike e pragmatike mbi themelin e kognicionit filologjik e filozofik.

Si qëndron Kosova në këtë dritë? Dobët. Shumë dobët. Vështirë të gjenden liderë e qeveritarë në politikën e sotme të Kosovës që të jenë oratorë të përgatitur, të cilët mund ta ndjekin e ta zbatojnë këtë ecuri fjalimi. Sepse, ata (oratorët) nuk kanë dituri elementare nga politolinguistika dhe kjo nënkupton faktin se nuk mund të merren me politikë efektive. Fjalimi, politikisht i ngritur, duhet të jetë, ndër të tjera, edhe rezultat i ndërveprimit të këtyre dy shkencave. Dhe, nuk mund të merren me politikë të këtillë (të studiuar) ngase u mungon përgatitja teorike e praktike: një numër i madh i "politikanëve" të sotëm të Kosovës, nga njerëz të papunë, pa profesion, përmes shpërdorimesh të ndryshme, kanë kërcyer në tarracën më të lartë politike pa kaluar, së paku, ndonjë shkallë të ngritjes e të përvojës dhe janë bërë: kryeministra, ministra, zëvendësministra, deputetë etj. Dmth. ministritë janë shndërruar në ente të papunësisë! Kjo është e vërteta e politikës së Kosovës sot. Prandaj, ç'mund të pritet nga institucionet relevante të shtetit që drejtohen nga sqimatarët e narcistët, nga batakçinjtë e kukuvriqët, nga karagjozët e snobistët, nga kusarët e zuzarët, nga eristikët e poltronët e të tjerë të këtillë?! Asgjë. Kështu shteti nuk mund të shkojë asnjë gjurmë përpara. Madje janë shumë të arsyeshme reagimet e disa diplomatëve të huaj e shqiptarë sipas të cilëve qeveritarët e tanishëm të Kosovës, me veprimtarinë e tyre të politikës diletante, komike e të ndonjë interesi privat dhe të ngushtë, jo vetëm që nuk janë të përgatitur për ta shpënë përpara zhvillimin e shtetit, por as që janë të aftë ta ruajnë të pacenuar sovranitetin e vendit në kufijtë në të cilët Kosova u pranua shtet! Duket se drejtuesit e shtetit nuk i dinë mirë as kompetencat kushtetuese, prandaj janë të gatshëm të zhvillojnë dialog edhe për territoret e Kosovës që ndërkombëtarisht janë të garantuara si të paprekura!

Në gjuhën shqipe politolinguistika ende nuk është konstituuar si dije e veçantë; ajo nënkupton hulumtimin shkencor dhe ndërtimin e tekstit të komunikimit posaçërisht në fushat e trajtimit të temave politike, diplomatike etj. Andaj, mund të thuhet se disiplina shkencore që ndjek kundrimin dhe zbërthimin e temave të ndryshme nga strategjia e studiuar politike, të cilën e pasqyron me mjete të përzgjedhura gjuhësore të vëna në tekstëzim të patrandur semantik me të cilin (tekstëzim) krijon ide bindjeje dhe zgjidhjeje, emërtohet me termin politolinguistikë.

Komunikimi cilësor i paraprin veprimit të matur politik. Ai krijon opinionin pozitiv për subjektin politik dhe për temën e trajtimit. Politika hartohet, përgatitet, ndikohet, rregullohet, motivohet, kontrollohet, kritikohet dhe pasqyrohet përmes gjuhës, prandaj gjuha e politikës duhet të jetë e përzgjedhur dhe e strukturuar sipas kritereve të pragmalinguistikës, të retorikës, por edhe të shkencave të tjera të komunikimit. A. Burkhardt shkruan: "Das Leben des Politikers ist reden, schreiben, lesen...": "Jeta e politikanit është të flasë, të shkruajë, të lexojë..." (A. B., Das Parlament..., f. 117)

Në Gjermani dhe në shtetet e tjera të zhvilluara zhvillimi i shkencave politike e shpuri përpara edhe komunikimin politik, i cili mund të ngrihet lart, të tumiret nga opinioni dhe të ketë efekt pozitiv vetëm nga oratorët kompetitivë, do të thotë nga oratorët me erudicion dhe elokucion të ngritur.

## Politika pa kritere

Por, hëpërhë në skenën politike të Kosovës nuk ka oratorë me intensionalitet, me kapital politik, me erudicion dhe elokucion të lartë të stilit politik, të cilët dinë të reagojnë politikisht në të gjitha situatat dhe propozimet që mund të shtrohen përpara

# fjalimi politik

shtetit madje edhe për temat më delikate siç është rasti i "shkëmbimit të territoreve". Sepse, përderisa në politikë mund të hyjë secili që ka interferenca farefisnore, politike, miqësore etj. me liderët politikë dhe pushtetarët, është alogjike të pritet se në skenën e sotme politike ka politikanë të lartë politikisht të ngritur, por edhe korrektë për t'i neutralizuar e për t'i hedhur poshtë me dëshmi të pakontestueshme që i ka Kosova, tendencat e temat që prekin sovranitetin territorial të shtetit. Për sovranitetin e shtetit jo vetëm që nuk mund të bëhet kompromis, por as nuk duhet të pranohet të shtrohet si temë trajtimi. Vetëm ata që i besojnë retorikës destruktive e negative mund ta pranojnë diskutimin për sovranitetin e shtetit. Kështu ndodh kur zhvillohet politikë pa kritere. Prandaj, nuk mund të flitet për komunikimin e matur e politikisht të pjekur në debatet politike, në fjalimet politike, në takimet ndërkombëtare etj.; për këtë arsye nuk është habi që në institucionet shtetërore të vendit shumë shpesh mund të dëgjohen ndërhyrje e grindje të stilit apolitik e antietik. Politolinguistika është shkencë me shumë rëndësi në komunikimin politik dhe veprimi politik është i lidhur ngushtësisht me tekstndërtimin e komunikimit politik. Gjuha, siç shkruan Edelmani është "jo thjesht një lloj veprimi, por çelës i botës për folësin e dëgjuesin". (Aty.) Komunikimi politik, varësisht nga përmbajtja dhe qëllimi, mund të nxisë përjetime e bindje të ndryshme: raporte miqësie e bashkëpunimi, zgjidhje konfliktesh, tejkalim situatash të ndera, kompromise, paqe, marrëveshje me interes të ndërsjellë ose: mund të krijojë urrejtje mbi baza nacionale, politike, konfesionale, rajonale, sociale, mund të krijojë vatra krize, destabilizim, izolim politik, shkencor, ekonomik, thellim konfliktesh e mospajtimesh, embargo e acarime ndërshtetërore, ndërnjerëzore etj. Dialogu politik është pjesë e debatit politik, është trajtim i thukët i temës së shtruar nga pjesëmarrësit në debat apo në tribunën politike. Edhe në këso ndërkomunikimesh duhet të mbizotërojë stili persuasiv, etik, stili i vlerave sociokulturore, argumentimi i dështimeve të kundërshtarëve politikë, por pa e cenuar identitetin e folësve, demonstrimi i parashikimeve programore reale për të ardhmen etj.

Komunikimi politik duhet të jetë i ndërthurur me një sistem të pasur shenjash gjuhësore dhe figurash funksionale me anë të të cilave ngrihet meditimi pragmatik i ndjekur nga stili apodiktik dhe koherent rreth temave të shtruara për trajtim. Si kokonstituent i temave duhet të parashtrohet edhe rema madje rema që nuk glorifikon, por që hap shtigje perspektivash e zgjidhjesh të reja në fushën e komunikimit. Kështu komunikimi politik është strukturë specifike e shprehjes së mendimit, strukturë e seleksionuar nga polisemia leksikore e një gjuhe dhe nga ndërlidhja e mjeteve stilistike-gjuhësore e metaforike përkitazi me temën e trajtimit. Ai nuk mund të ketë liri të gjerë inventive sepse komunikimi politik do pragmatikë mbi bazë veprimi për të bindur opinionin e rivalët politikë për krijimin e sendërtimin e realiteteve të spektrit të interesit të përgjithshëm nacional, komunal, shtetëror etj., të cilat realitete hapin shtigje të reja avancimi në fusha të ndryshme zhvillimi.

Komunikimi politik duhet të jetë bindës në kuptimin e "ndikimit të njerëzve te njerëzit përmes njerëzve me mjetet e gjuhës".



# Bahtiri kërkon nga drejtorët që Mitrovicën ta bëjnë qytetin më të pastër në Kosovë

MITROVICË, 10 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka kryesuar mbledhjen e radhës të Bordit të Drejtorëve, në të cilën janë diskutuar dhe shqyrtuar çështje të rëndësishme nga fushëveprimi i Bordit dhe drejtorive komunale.

Fillimisht fjalën e mori drejtori i Drejtorisë së Inspekcionit, Hysni Ahmeti, i cili ka informuar për aksionin e ndërmarrë nga kjo drejtori ditë më parë për rrënimin e katër shtëpive te liqeni akumulues, duke theksuar se gjatë realizimit të aksionit nuk ka pasur probleme. Ai ka bërë me dije se gjatë kësaj jave do të vendoset edhe për rrënimin e dy shtëpive të tjera që gjenden në afërsi të liqenit akumulues.

Kryetari Bahtiri ka thënë se ka konsideratë për familjarët të cilëve u kanë rrënuar shtëpitë, mirëpo ky vendim është marrë në harmoni me ligjin dhe me pëlqimin e Kuvendit Komunal, me qëllim të të vazhdimit me realizimin e projekteve madhore të cilat do t'ia shtojnë bukurinë qytetit të Mitrovicës. Ai ka thënë se projekti për ndërtimin e shtëpive për familjet me gjendje të rëndë ekonomiko-sociale do të realizohet ashtu sikur është parapa dhe këtë nuk mund ta ndalojë askush. "Vendimet e Kuvendit të Komunës nuk mund t'i ndryshojë askush, pa marrë parasysh presionet dhe shantazhet që mund të vijnë nga njerëz apo grupe të ndryshme që i bëjnë për interesa të tyre", ka thënë Bahtiri. Në mbledhje u diskutua edhe për organizimin e aktiviteteve për aksionin "Ta pastrojmë Kosovën" të organizuar nga Qeveria e Kosovës.

Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtjen e Mjedisit, Asllan Isufi, ka thënë se nga 15 shtatori do të organizohet aksioni masiv për pastrimin e mbeturinave në gjithë Kosovën, ndërsa ky aksion në Mitrovicë do të zhvillohet nga 1 tetori deri më 13 tetor të këtij viti. Drejtori Isufi ka bërë me dije se komuna i ka bërë të gjitha përgatitjet për realizimin e këtij aksioni me qëllim që Mitrovica të jetë një qytet sa më i pastër, andaj kërkon që edhe qytetarët të jenë të vetëdijshëm për rëndësinë e një mjedisi sa më të pastër dhe t'i bashkëngjiten aksionit.

Kryetari Bahtiri, duke u ndërlidhur me këtë çështje, ka theksuar se në aksion duhet ta japin kontributin e tyre edhe të gjitha drejtoritë komunale, në mënyrë që aksioni të përfundojë me sukses dhe që Mitrovica të jetë përfituese e grandit për komunat që tregojnë performancë më të mirë.

## Trumpi kritikon ashpër librin për presidencën e tij

**Uashington, 10 shtator** - Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, kritikoi përsëri ashpër librin e ri të autorit Bob Woodward që bën fjalë për presidencën e tij, duke e quajtur një tjetër sulm të zakonshëm, në morinë e sulmeve të tjera kundër tij. "Libri i Woodwardit është një shaka", tha Trumpi, duke iu përgjigjur përshkrimeve tepër kritike të gazetarit hulumtues për presidencën e tij kaotike. Libri, i titulluar "Frikë: Trump në Shtëpinë e Bardhë", del në qarkullim sot (e martë) dhe është qysh tani ndër titujt më të shitur në rrjetin Amazon.
Presidenti Trump shkruante në Twitter se Woodward ka përdorur në libër "burime anonime, të provuara si të pavërteta". Shumë njerëz, shkruan ai, tashmë kanë deklaruar se citimet e tyre, ashtu si edhe vetë libri, janë të sajuara. "Demokratët, - vazhdon presidenti, - nuk mund ta durojnë dot humbjen; unë do të shkruaj librin e vërtetë".
Bob Woodward fitoi famë si gazetar rreth pesë dekada më parë si njëri nga reporterët e gazetës "Washington Post", raportimet e të cilëve rreth korrupsionit në Shtëpinë e Bardhë çuan në dorëheqjen e presidentit Richard Nixon. Ai ka shkruar libra rreth tetë presidentëve amerikanë.




# Zgjedhjet në Suedi shkaktojnë bllokadë politike

Rezultati i zgjedhjeve parlamentare të së dielës në Suedi i ka dhënë qendrës së majtë 144 ulëse në krahasim me 142 vende të tjera për Aleancën në Parlamentin me 349 ulëse, duke parashikuar kështu disa javë të pasigurisë para se të formohet qeveria e re



**Stokholm, 10 shtator** - Zgjedhjet e përgjithshme në Suedi kanë rezultuar me varësi në mes të dy blloqeve kryesore politike, derisa është vërejtur rritje e mbështetjes për partinë kundër migrimit, krahasuar me rezultatet e zgjedhjeve të kaluara.
Partitë e së djathtës ekstreme kanë shënuar rritje tejet të madhe në gjithë Evropën në vitet e fundit teksa rriten shqetësimet për identitetin kombëtar dhe efektet e globalizimit dhe migrimit, duke përfshirë konfliktin e armatosur në Lindje të Mesme dhe Afrikën Veriore.
Në Suedi, një fluks prej 163 000 azilkërkuesve më 2015, njëherësh më i madhi në ndonjë vend të Evropës, krahasuar me popullsinë e këtij vendi prej 10 milionë banorësh, ka ndarë votuesit si dhe konsensusin afatgjatë politik në këtë shtet.
Pas pothuajse numërimit të të gjitha votave, Partia Social Demokrate që ka qenë në pushtet së bashku me Partinë e Gjelbër dhe aleatët parlamentarë të majtë kanë fituar 40.6 për qind të votave, derisa Aleanca opozitare e qendrës së djathtë ka fituar 40.3 për qind.
Ky rezultat i ka dhënë qendrës së majtë 144 ulëse në krahasim me 142 vende të tjera për Aleancën në Parlamentin me 349 ulëse, duke parashikuar kështu disa javë të pasigurisë para se të formohet qeveria e re.
Partia e Demokratëve të Suedisë, e cila ka rrënjë të supremacistëve të bardhë, ka fituar 17.6 për qind të votave, apo 63 ulëse, në krahasim me 49 sa kishte në zgjedhjet e katër vjetëve më parë, duke shënuar kështu rritjen më të madhe në Parlamentin e Suedisë.
Rezultatet kanë qenë në linjë me sondazhet paraprake, pavarësisht se asnjëra nga to nuk ka parashikuar një rritje aq të madhe të Partisë së Demokratëve të Suedisë.
Lideri i kësaj partie, Jimmie Akesson, ka thënë se pavarësisht pse nuk kanë arritur të fitojnë 20 për qind të votave, siç kishte deklaruar më parë, partia e tij është fituese e zgjedhjeve. "Ne do të kemi ndikim të madh rreth asaj që do të ndodhë në Suedi në javët, muajt dhe vitet që vijnë", ka thënë Akesson para kolegëve të tij partiakë.
Akession shpreson që partia e tij, e cila synon ta largojë Suedinë nga Bashkimi Evropian dhe ta ngrijë çështjen e migrimit, do të luajë një rol vendimtar në negociatat për formimin e Qeverisë së re. Ai i ka bërë thirrje kandidatit të qendrës së djathtë të Aleancës, Ulf Kristersson, për bashkëpunim mes të dy palëve apo të pranojë edhe për katër vjet të tjera kryeministrin e Social Demokratëve, Stefan Lofven.
Kristersson i ka bërë thirrje Lofven për dorëheqje, mirëpo edhe ka kundërshtuar Akessonin. "Ne kemi qenë plotësisht të qartë gjatë gjithë procesit zgjedhor. Aleanca nuk do të qeverisë apo të diskutojë për formim të Qeverisë me Social Demokratët", ka thënë ai.
Demokratët e Suedisë, në anën tjetër, të lënë anash nga të gjitha partitë prej kur kanë hyrë në parlament më 2010, kanë premtuar se do t'i fundosin përpjekjet e secilit kabinet, që refuzon t'ua japë atyre të drejtën e fjalës në politikë, sidomos në çështjet e imigrimit.
Mirëpo Lofven ka thënë se nuk do të japë dorëheqje dhe ka bërë thirrje për bashkëpunim, në mënyrë që të zgjidhet bllokada politike. "Nuk ka asnjë anë të shumicës. Prandaj është e natyrshme të punojmë përtej ndasive politike për ta bërë të mundur qeverisjen e Suedisë", ka thënë ai.

### Rritje të zërave euroskeptikë

Rezultatet e këtyre zgjedhjeve do t'i shtojnë shqetësimet në Bruksel, meqë Bashkimi Evropian hyn në kohën e fushatës për zgjedhjet në Parlamentin Evropian në muajin maj, çka mund të ndikojë në fuqizim të zërave eurospektikë dhe t'i dobësojë përpjekjet për një integrim më të madh në BE.
Niveli rekord i azilkërkuesve më 2015 ka rritur shqetësimet për sistemin e mirëqenies në Suedi, pasi për shumë votues Suedia tashmë veçse është në krizë, pavarësisht se numri i refugjatëve ka rënë ndjeshëm që nga ajo kohë.
Pritjet në radhë të gjata për operacione kritike, zvogëlimi i numrit të mjekëve dhe mësuesve, si dhe dështimi për t'u përballur me grupe të dhunshme ka shkundur besimin në "modelin suedez", të ndërtuar në një mirëqenie të përbashkët dhe gjithëpërfshirje shoqërore.
Studenti 32 vjeçar, Katze Collmar, i cili ka votuar në qendër të Stokholmit ka thënë se fushata ka qenë "shumë e pakëndshme". "Duket se Suedia mund të bëjë një hap në këto zgjedhje, nga i cili nuk do të mund të kthehemi si kemi qenë aq shpejt", tha ai.
Lofven mund të mbetet në pushtet, përveç rastit kur Aleanca do të kishte mbështetjen e Demokratëve të Suedisë, çka mund të kushtojë me zëra më të fuqishëm të politikës kundër migrantëve. Andaj atij i duhet të tejkalojë dekada të armiqësisë në mes të dy blloqeve dhe të fitojë përkrahjen e partive të qendrës së djathtë, diçka që tashmë të dyja palët e kanë hedhur poshtë.

## Putini do të diskutojë për Korenë Veriore me liderët aziatikë

**Moskë, 10 shtator** - Presidenti rus, Vladimir Putin, pritet të zhvillojë bisedime me liderët aziatikë këtë javë, në të cilat do të përfshihet edhe programi bërthamor i Koresë Veriore, në kohën kur Phenjani ka ndalur përpjekjet për t'i ulur tensionet me Uashingtonin.
Putini do të takohet me kryeministrin japonez, Shinzo Abe, kryeministrin e Kinës, Xi Jinping dhe kryeministrin e Koresë Jugore, Lee Nak-yeon në qytetin lindor të Rusisë, Vladivostok, i cili është nikoqir i Forumit Ekonomik Lindor më 11-13 shtator.
Në takimin e tij më 10 shtator me kryeministrin Abe, Putini pritet të fokusohet në "rritjen e bashkëpunimit ekonomik dhe shkëmbimit tregtar", si dhe në këmbimin e pikëpamjeve për situatën në Gadishullin Korean, ka thënë ndihmësi i lartë për politike të Jashtme i Putinit, Yury Ushakov. Abe u ka thënë gazetarëve më 10 shtator se ai dhe Putini po ashtu do të diskutojnë edhe për një konflikt për Ishujt Kurile, territor të cilin të dyja shtetet e emërojnë ndryshe.



# Fundi i verës, si t'i japim jetëgjatësi nxirjes

**Ja cilat janë masat paraprake që duhet të marrim dhe truket e vogla për të ruajtur ngjyrën e bukur pas pushimeve sa më shumë që të jetë e mundur në lëkurë**



Një nga shenjat e mirëqenies që na kanë dhënë pushimet është ngjyra e bukur që kemi në fytyrën dhe trupin tonë: fakti që e shohim veten të nxirë na bën një humor më të mirë dhe e bën më të lehtë kthimin në zakonet përditshme. Qëllimi është, pra, të mbajmë ngjyrën për aq kohë sa të jetë e mundur. Gjëja e parë që duhet të dimë është se cikli jetësor i qelizave të epidermës është rreth 28 ditë, pas së cilës ata vdesin dhe vendi i tyre merret nga qelizat e reja dhe jo të nxira: nxirja jonë është e destinuar … të na lërë . Por, le të zbulojmë se cilat janë masat që duhet të zbatohen në rutinën tonë të bukurisë për t'i "zgjatur jetën" sa më shumë që të jetë e mundur ngjyrës sonë të verës.

**Dielli "nuk mbyllet" –** Për fat të mirë, rrezet e diellit janë në dispozicion edhe në qytet. Nuk nxiheni si në det apo në mal, pasi ajri është më pak i qartë, por ata bëjnë punën e tyre gjithsesi. Nuk duhet t'i humbim mundësitë që të ekspozojmë veten në dritë sa më shumë që të jetë e mundur: ne mund të ecim, ngasim një biçikletë, të krijojmë një dhomë me diell në ballkonin e shtëpisë, nëse kemi hapësirë dhe privatësi të mjaftueshme. Ose, nëse koha është e mirë, mund të kalojmë një ditë në një pishinë të hapur, në liqen ose në një lëndinë jashtë qytetit. Rrezet UV do të ndihmojnë lëkurën tonë të prodhojë melaninën e re, duke ripërtërirë cirkun.

**Larja zhduk nxirjen –** Ne preferojmë dushin në krahasim me banjën: fakti i zhytjes plotësisht në ujë promovon zbukurimin e lëkurës, veçanërisht nëse përdorim ujë shumë të nxehtë. Dush, megjithatë, jo shumë i zgjatur dhe i bërë me ujë të freskët, e ndihmon lëkurën të ruajë elasticitetin e saj. Më mirë i shmangni banjat e shkumëzuara të flluskave, zgjidhni produktet hidratuese dhe vajrat e banjës. Kur thahemi, nuk duhet ta fërkojmë trupin me peshqir.

**Hidratimi –** Është aleati ynë më i mirë. Momenti ideal për të ushqyer lëkurën është pas dushit: një kalim i mirë kremi mbi tërë trupin është hapi i parë për të mbajtur një lëkurë të butë dhe elastike. Përveç kozmetikës së zakonshme, mund të provoni disa produkte natyrale si vaji Argan ose gjalpë Karite, ideale për lëkurë shumë të thatë. Le të mos harrojmë gjithashtu të hidratohemi "nga brenda", domethënë të pimë shumë ujë. Uji, përveç ruajtjes së ekuilibrit të trupit tonë, ndihmon në kullimin e lëngjeve të tepërta dhe na mban në formë.

**Pastrim –** Kjo mund të duket paradoksale, por për të mbajtur një epidermë të gjallë dhe të ndritshme, qelizat e vdekura duhet të hiqen, madje edhe nëse ato janë të zeza. Një shtresë e lehtë dhe delikate, që do të përdoret një herë në javë, është hapi i parë për t'i dhënë lëkurës një aspekt veror. Gjithashtu ajo do të heqë qelizat e vdekura.

**Në pjatë dhe në gotë –** Një dietë e shëndetshme, e balancuar dhe e pasur me beta-carotene, përmirëson shëndetin e lëkurës dhe e bën atë të ndritshme dhe të gjallë. Ne mund të zgjedhim fruta dhe perime sezonale, duke favorizuar ata me ngjyrë portokalli si karota, kajsi e fundit, kungulli, manaferrat e egra dhe domate, të pasura me antocianë dhe lycopene. Gjithashtu janë të shkëlqyera ekstraktet dhe centrifugat për të pirë, për shembull, mollë dhe karota.

**Kujdes me ajrin –** Kondicionimi i ajrit, por edhe rrjedha e ventilatorit, sidomos nëse drejtohet drejtpërsëdrejti, dehidraton lëkurën dhe shkurton jetëgjatësinë e nxirjes. Kujdes pastaj për kondicionerët e zyrës dhe makinës: meqenëse temperaturat nuk janë më të nxehta, ne mund të përpiqemi të bëjmë më pak ftohje artificiale.

**Edhe mund të mashtroni pak –** Të vraposh për një nxirje të mirë të lëkurës, është gjithmonë një zgjidhje ekstreme, por e justifikueshme. Vetëm zgjidhni një produkt të mirë, që do të përdoret vetëm ose, për një efekt më të matur, duke përzier një sasi të vogël të kremit hidratues që ne zakonisht përdorim. Edhe një make-up i mirë, i lehtë dhe natyral, mund të theksojë ngjyrën e bukur të verës dhe ta ringjallë atë, kur ajo tenton të zbehet dhe ka nevojë për një ndihmë të vogël. Vetëm zgjidhni produktet e bronzit me një cilësi delikate dhe shkëlqim të ndritshëm, për të ringjallur shkëlqimin e verës.

*(gazeta-Shqip.com)*

E jashtëzakonshme

# Në Australi zbulohen dy shkëmbinj të mëdhenj me ari



Minatorët në Australinë Perëndimore kanë njoftuar se kanë zbuluar dy shkëmbinj të mëdhenj me ari, që vlerësohen në miliona dollarë. "Guri më i madh, me peshë 95 kilogramë, përmban 68 kilogramë ari", ka njoftuar kompania minerare kanadeze "RNC Minerals". Ari ka vlerë rreth 15 milionë dollarë.

## FOTO E DITES



Ushtarët shkatërrojnë një plantacion marijuane në Meksikë. /AFP/

E rrallë

# Pirja e urinës ndihmon për humbje të peshës?



Julia Sillaman nga Maryland filloi terapinë e urinës për shkak të akneve të saj të rënda, shkruan "Daily Mail". Ndërsa Christo Dabraccio, një meteorolog nga Idaho, thotë se pirja e urinës e ndihmoi atë të humbte peshë rreth 13 kilogramë. Pirja e urinës për përfitime shëndetësore mendohet se daton qindra vjet më parë.

## BARSOLETA E DITËS



**Gjyqtari pyet të dëmtuarin:**
**- Thoni se i akuzuari ju qëlloi me kovë në kokë?**
**- Mu në mes.**
**- Po në kokën tuaj nuk vërehet asgjë.**
**- Ndoshta, por shikojeni kovën si është bërë!**

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit
në ora 16:00

### " INCREDIBLES 2" 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

**Rolet:** Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

**Regjia:** Brad Bird







Në ora 18:20

### "FUTURE WORLD"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

**Regjia:** James Franco

Në ora 20:00

### "ANT-MAN AND THE WASP" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

**Rolet:** Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

**Regjia:** Peyton Reed






Në ora 22:00

### "LOVING PABLO" (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 m

**Rolet:** Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

**Regjia:** Fernando León de Aranoa

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Keni shumë gjëra pozitive si tip, jeni të ndershëm dhe mjaft korrekt me ata që ju rrethojnë. Sot kjo gjë do të vlerësohet.



**DEMI**
Si fillim duhet ta krijoni terrenin e përshtatshëm, pastaj të procedoni për t'i realizuar projektet tuaja ambicioze.



**BINJAKËT**
Kurioziteti është arma juaj kryesore sot dhe është dhe një nga virtytet tuaja më të mira. Gjithmonë kërkoni informacion përpara se të vepronі.



**GAFORRJA**
Miqtë mund të kenë gjithmonë besim tek ju se dini t'i ruani sekretet dhe jeni mjaft të rezervuar për t'i shprehur ndjenjat tuaja.



**LUANI**
Edhe pse dëshironi të dominoni dhe të jeni gjithmonë në rolin e liderit, sot do të dini të ofroheni me shumë qetësi për një mbështetje morale.



**VIRGJËRESHA**
Edhe pse ditët që do të vijnë do të keni shumë ngarkesë në punë, do të dini se si ta përballoni më së miri.



**PESHORJA**
Mundohuni të jeni të kuptueshëm sot dhe mateni fjalët që thoni. Mund të lëndoni pa dashje dike për të cilin keni shumë respekt.



**AKREPI**
Gjithmonë arrini t'i gjeni zgjidhjet shumë më përpara të tjerëve falë intuitës suaj të pagabueshme që ju ndihmon gjithmonë.



**SHIGJETARI**
Optimiste dhe pozitive gjithmonë e shikoni gotën gjysmë plot, por edhe tek njerëzit përçoni të njëjtën ndjesi.



**BRICJAPI**
Nuk ju tremb aspak koha që duhet të impenjoheni për të zgjidhur një çështje të caktuar. Jeni mjaft i përqendruar në detaje.



**UJORI**
Mendoni se të tjerët përkushtohen ndaj jush në të njëjtën mënyrë si ju ndaj tyre. Sot do të pësoni një zhgënjim lidhur me një person.



**PESHQIT**
Shumë shpesh humbni në botën e ndjenjave, por kjo gjë ju bën shumë të ndikueshëm dhe mjaft të paqëndrueshëm.

# Rita 'shkund' Londrën në koncertin e BBC Radio 2



Këngëtarja shqiptare me famë botërore, Rita Ora, vazhdon të jetë e angazhuar me koncerte të shumta. Këtë herë ajo ka performuar në qytetin ku u rrit, në Londër, në koncertin e organizuar në kuadër të BBC Radio 2. Ajo ka kënduar 'live' para mijëra fansave hitet e saj më të fundit, ndërsa ka bërë sërish një rikujtim të shkurtër për Aviciin gjatë interpretimit të këngës "Lonely together".

# Majk ndërron profesion? Tani edhe aktor



Reperi i njohur Majk ka arritur sukses të madh në karrierën muzikore, por ai ka vendosur ta sprovojë veten edhe në një fushë tjetër në aktrim. Lajmi është konfirmuar nga vetë këngëtari në një postim në "InstaStory". Filmi quhet 'Diamanti'. Mbetet për t'u parë se sa sukses do të ketë Majk në aktrim.



# Jennifer Garneri në kishë me nënën e Ben Affleckut

Jennifer Garneri ka bërë pak pushim nga turneu promovues i filmit të saj më të ri 'Peppermint' për të kaluar të dielën me fëmijët dhe ish-vjehrrën e saj. 46-vjeçarja u filmua mëngjesin e së dielës në Los Angelos duke shkuar në kishë me familjen e saj, ndërsa ish-bashkëshorti Ben përfundoi trajtimin në një qendër rehabilitimi. Nëna e Affleck, Christine u bashkua me ish-nusen e saj dhe tre nipërit e saj për në shërbesën fetare. Jenniferi dukej shumë e qeshur dhe e lumtur.

# Sophie Turner shtatzënë?



Gati një vit pasi Sophie Turner dhe Joe Jonas kanë shpallur fejesën e tyre, u raportua se aktorja e "Game of Thrones" mund të jetë shtatzënë. Kështu të paktën ka thënë një burim i afërt për "New York Post" që, së fundmi, ka parë aktoren 22-vjeçare dhe muzikantin 20-vjeçar në Nju Jork. "Ajo dukej shtatzënë. Ajo e kishte shkëlqimin që vetëm një grua shtatzënë e ka", ka thënë ky burim, duke shtuar se aktorja britanike po ashtu nuk konsumonte alkool.




Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

| PROGNOZA SPORTIVE | JAPAN - COSTA RICA | 1 | POLAND - REP OF IRELAND | 1 | ENGLAND - SWITZERLAND | GG |
|---|---|---|---|---|---|---|

# Theodoridisi: Futbolli i Kosovës do ta ketë përkrahjen e UEFA-s

UEFA edhe një herë e ka konfirmuar mbështetjen për Federatën e Futbollit të Kosovës. "Ne e kemi për obligim t'i ndihmojmë federatat anëtare dhe do ta vazhdojmë përkrahjen për ju", ka thënë Theodore Theodoridis, sekretari gjeneral i UEFA-s

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

**Prishtinë, 10 shtator** - Sekretari gjeneral i UEFA-s, Theodore Theodoridis, me bashkëpunëtorët Thierry Favre dhe Denis Bastari, e kanë vizituar të hënën Federatën e Futbollit të Kosovës. Zyrtarët e UEFA-s janë pritur nga kryetari Agim Ademi dhe sekretari i përgjithshëm i FFK-së, Eroll Salihu. Kryetari Ademi i ka njoftuar mysafirët me punën që po bën federata, kurse ka premtuar ruajtjen e miqësisë dhe ka premtuar thellimin e bashkëpunimit me UEFA-n, ashtu sikurse ish-kryetari i FFK-së, Fadil Vokrri. "Më kujtohet shumë mirë telefonata juaj për presidentin Vokrri një ditë para pranimit. Ka qenë një bisedë shumë e rëndësishme. Edhe ish-presidenti Vokrri ka pasur një respekt të madh për ju dhe të njëjtin respekt e keni nga të gjithë ne që jemi pjesë e futbollit të Kosovës dhe do të jemi falënderues gjithmonë për mbështetjen dhe këshillat që na i keni dhënë. E ndiej veten shumë mirë që të gjithë kemi qenë bashkëpunëtorë të tij për një kohë të gjatë dhe do të vazhdojmë ta mbajmë miqësinë dhe korrektësinë që ai ka pasur me UEFA-n", ka thënë Ademi, duke shtuar: "Federata ka filluar ta rimarrë veten pas vdekjes së ish-presidentit Vokrri dhe kemi filluar projektet rreth ndërtimit të stadiumeve me përkrahjen e UEFA-s e FIFA-s. Shumë shpejt do të nisim edhe me Kompleksin Sportiv të Kombëtares në Obiliq. Do ta vazhdojmë edhe renovimin e selisë së FFK-së ndërsa, krahas përmirësimit të infrastrukturës, jemi duke punuar në zhvillimin dhe



ngritjen e nivelit në ligat tona, duke përfshirë edhe futbollin e femrave". Ndërsa Theodore Theodoridis është shprehur i kënaqur me lëvizjet përpara që po bën futbolli i Kosovës, duke premtuar se ndihma e UEFA-s nuk do të ndalet për asnjë çast. "Herën e parë kur kam qenë keni pasur vetëm dy zyra të vogla. Më vjen mirë që tani keni hapësira shumë më të mëdha dhe kushte më të mira për punë. Jam i lumtur që nga vizita ime e parë këtu kanë ndryshuar shumë gjëra për të mirë, pasi jeni pranuar në UEFA e FIFA dhe keni zhvilluar edhe shumë ndeshje si me kombëtaren tuaj, po ashtu edhe me ekipet në garat evropiane. Ne e kemi për obligim të ndihmojmë federatat anëtare dhe do ta vazhdojmë përkrahjen për ju", ka thënë Theodoridis. Zyrtarët e UEFA-s të hënën në mbrëmje e kanë përcjellë ndeshjen e Ligës së Kombeve në mes të Kosovës dhe Ishujve Faroe.

## SHKURT

### Humbja nga Bashkimi ia "hanë" kokën Selmanit

Agron Semani nuk do të jetë më trajner i skuadrës së Vllaznisë së Pozheranit pasi klubi ka vendosur për shkarkimin e tij. Humbja e fundit si vendës ndaj Bashkimit (0-3) dhe një pikë e grumbulluar pas tri xhirosh ishin vendimtare për shkarkimin e Selmanit. "Pas mbledhjes së jashtëzakonshme në mes të kryesisë së klubit dhe Agron Selmanit erdhëm në përfundim ta shkëputim bashkëpunimin e mëtejmë. Selmanin e falënderojmë për kontributin e dhënë në klubin tonë, ndërsa për veprimet e mëtutjeshme si klub do t'ju njoftojmë me kohë", thuhet në njoftimin e Vllaznisë.

### Ajeti: Nuk ishte vështirë ta zgjedhja Zvicrën

Albion Ajeti ka treguar për "blick.ch" se që në vitin 2011 e kishte ëndërruar të luante për Zvicrën. Ai ka thënë se zgjedhja nuk ka qenë aspak e vështirë. "Për mua nuk ka qenë kurrë një temë e madhe, për ekipin kombëtar zviceran që kam dashur gjithmonë, madje që nga viti 2011. Në një ndeshje në 'Jakob-Park' që Zvicra po luante me Bullgarinë. Unë kapja topat dhe shihja në fushë Shaqirin. Mendoja edhe unë do të jem një ditë aty", ka thënë Ajeti.

### Besa Famgas kalon Batumin, kundërshtar i radhës Drammeni

Besa Famgas është kualifikuar në rrethin e dytë të Kupës së EHF-së, pasi në rrethin e parë e eliminoi Batumin e Gjeorgjisë ndaj së cilës arriti dy fitore. Të dielën në palestrën "Karagaçi" në Pejë Besa fitoi me rezultat 37:22. Pas pjesës së parë rezultati ishte 19:12 për vendësit. Në fakt, fitorja ka mundur të jetë edhe më e lartë, pasi pejanët ishin dominues gjatë tërë kohës. Por epërsia e lartë e krijuar herët dhe dallimi në cilësi i skuadrave bëri të veten, ndërsa në fund fitorja ishte shumë e thellë. Pejanët të shtunën në ndeshjen e parë kishin fituar me rezultat 30-20. Në xhiron e dytë Besa përballë do ta ketë skuadrën e madhe nga Norvegjia, Drammen, kurse ndeshja do të luhet në muajin tetor.

## Rikthehet Superliga, nesër derbi Drita - Llapi

**Prishtinë, 10 shtator** - Pas ndeshjeve të Përfaqësueses së Kosovës në Ligën e Kombeve, rikthehet IPKO Superliga me ndeshjet e xhiros së katërt. Dy ndeshjet e para për këtë xhiro zhvillohen sot (e martë) nga ora 15:45 dhe takohen Drenica-Gjilani dhe Ballkani-Prishtina. Në orar të njëjtë, por të mërkurën, zhvillohet derbi në mes të Dritës dhe Llapit. Skuadra kampione e Kosovës nuk po kalon formë të mirë dhe në këtë ndeshje synim do ta ketë fitoren, kurse Llapi i Bylbyl Sokolit është duke e ngritur formën nga ndeshja në ndeshje dhe nga Gjilani synon të mos rikthehet duarthatë. Në tri ndeshjet e tjera që zhvillohen të mërkurën do të takohen Ferizaj - Feronikeli, KEK-u - Trepça '89, Flamurtari - Liria.



## Lorik Cana i kthehet futbollit, por jo në Shqipëri



Tiranë, 10 shtator - Pavarësisht se ka dhënë "dorëheqje", Lorik Cana duket se nuk largohet kurrsesi nga ky sport. Së shpejti do të jetë drejtues i një klubi futbolli. Cana, sipas "Shekullit", ka folur për "Lalaziosiamonoi" ku është shprehur: "Kam një fondacion në Kosovë, ku jam themelues dhe president, punoj me të vegjlit. Merrem pak edhe me televizion, por brenda dy vjetëve do të filloj një karrierë si drejtues në botën e futbollit profesionist", ka thënë Cana. "Nuk dua absolutisht të largohem nga bota e futbollit, do të bëj gjëra të tjera nëpërmjet fondacionit dhe TV-së, por kam dëshirën ta provoj botën e drejtuesve. Ku? Jo në Shqipëri, por gjithsesi në Evropë", ka shtuar Cana.

# Shaqiri: Përvoja me Bayernin do të më ndihmojë të fitoj me Liverpoolin



Liverpool, 10 shtator - Xherdan Shaqiri u transferua te Liverpooli këtë afat kalimtar nga ekipi i Stoke Cityt për shumën e 13 milionë paundëve. Lojtari me origjinë shqiptare ka folur për revistën zyrtare të klubit, duke treguar rrugën e duhur për të arritur në fitimin e trofeve, që mungojnë prej gjashtë vjetësh në Liverpool. Ai ka fituar Ligën e Kampionëve, dy tituj Kampionë, Kupën e Gjermanisë dhe Botërorin e Klubeve gjatë përvojës me Bayern Munchenin dhe dëshiron t'i ndihmojë shokët e skuadrës për t'u rikthyer te fitimi i trofeve. "Objektivi i klubit është të fitojë diçka dhe ky duhet të jetë edhe qëllimi i skuadrës sonë. Ne duhet t'i marrim ndeshjet një nga një dhe të tentojmë t'i fitojmë të gjitha. Më pas do të mendojmë mbas fitores së një ndeshje: 'OK', të vazhdojmë përpara dhe ta shohim ndeshjen e radhës'. Kjo është mënyra për të arritur te titujt dhe shpresoj se do t'ia arrijmë këtë sezon të fitojmë", ka thënë Shaqiri. "Mbi të gjitha, ne duam të përpiqemi të luajmë një futboll të bukur. Por, e dimë se ndonjëherë nuk vlen vetëm futbolli i bukur për të fituar, kështu që duhet të dimë si t'i fitojmë ndeshjet. Kjo është e rëndësishme për të konkurruar me ekipet e tjera. Si një futbollist i ri në ekip, unë dua ta luaj futbollin tim. Shumica e lojtarëve më njohin që kam luajtur në Premierë dhe me Bayernin. Kam fituar shumë tituj me Bayernin dhe dua ta vendos përvojën time në funksion të Liverpoolit. Jemi ekip i ri në moshë dhe dua t'i ndihmoj shokët për të fituar trofe", ka deklaruar Shaqiri.

# Williamsi dënohet 17 mijë dollarë

Nju Jork, 10 shtator - Serena Williams ka marrë një gjobë monetare me një vlerë totale 17 000 dollarë për dhunën e trefishtë të ushtruar në finalen e US Open. Ajo është dënuar me 10 000 dollarë për "dhunë verbale" ndaj arbitrit Carlos Ramos, 4 000 dollarë për marrjen e udhëzimeve nga trajneri i saj dhe 3 000 të tjera për thyerjen e raketës nga nervat. 23 herë fituesja e Grand Slamit e ka quajtur arbitrin "hajdut", konkretisht i ka thënë: "Nuk ishte gjykim ky. Unë nuk bëj hile që të fitoj. Më mirë humbas. Thjesht, që ta dish. Unë nuk kam bërë kurrë hile në jetën time. Më ke borxh një të kërkuar falje. Unë kam një vajzë dhe s'kam bërë hile në jetën time. Po sulmon karakterin tim dhe duhet të kërkosh të falur. Je një gënjeshtar. Nuk do të gjykosh më kurrë një ndeshje timen. Më kërko falje. Ti vodhe një pikë nga unë, ti je një hajdut".



## SHKURT

### Gjermania - Adidas vazhdojnë së bashku deri më 2026

Futbollistët dhe trajneri Joachim Low dhe stafi teknik do të vazhdojnë të vishen me tri vijat e famshme teksa Federata Gjermane e Futbollit ka rinovuar kontratën me Adidasin deri më 2026. Kontrata e ish-kampionëve të botës është zgjatur me katër vjet të tjera. Këtë e ka konfirmuar kompania e dytë më e madhe sportive dhe Federata Gjermane ditën e hënë. Adidasi vesh të gjitha përfaqësueset DFB dhe si shpërblim mund të bëjë mjaftueshëm reklama me lojtarët e lojtarëve të përfaqësuese si dhe t'i shesë fanellat zyrtare. Nuk është konfirmuar shifra e marrëveshjes. Partneriteti ka më shumë se 60 vjet që ekziston. "DFB dhe Adidas duhet të mbeten gjithmonë të bashkuar. Kemi një partneritet shumëvjeçar, prandaj është kaq e rëndësishme", është shprehur një nga drejtuesit e Adidasit, Kasper Rorsted.

### Djokoviqi, fitues i US Open

Novak Djokoviq është fituesi i Grand Slamit të fundit të këtij viti. Tenisti serb triumfoi në US Open, duke mundur në finale argjentinasin Juan Manuel Del Potro 3-0 me sete. 6-3, 7-6 dhe 6-3 ishte rezultati i ndeshjes që zgjati 3 orë e 15 minuta. Ky është titulli i 14 Grand Slam për serbin (i treti në US Open), i cili barazon kështu me amerikanin Pete Sampras, ndërkohë që i afrohet në renditjen historike Rafael Nadalit (16), ndërsa Federerin e shikon më larg (20).

### Hiddinki, trajner i Kinës U21

Guus Hiddink u emërua të hënën trajner i kombëtares U21 të Kinës dhe do ta çojë ekipin në Olimpiadën e Tokios në vitin 2020. Ekipi i parë kombëtar i Kinës renditet i 75-ti në ranglistën botërore të FIFA-s dhe ka një tjetër trajner të shquar në stol: Marcello Lippi, që nga viti 2016. Sipas medieve kineze, Hiddink do të paguhet gati 4 milionë euro në vit.

### Makelele: Sarri mund ta bëjë historinë me Chelsean

Ish-mesfushori i Chelseat, Claudio Makelele, i ka dalë në përkrahje trajnerit të skuadrës, Maurizio Sarri. Sipas Makeles, trajneri Sarri mund ta bëjë historinë me Chelsean. "Mendoj se Chelsea ka ndryshuar shumë. Manchester City dhe Unitedi kanë lojtarë shumë të mirë, por edhe skuadrat e vogla janë kompetitive. Por, kam besim se Chelsea mund t'ia dal. Sarri ka aftësitë ta bëjë historinë me Chelsean", ka thënë Makelele.

### Pjaniqi: Juve me Ronaldon e fiton Ligën e Kampionëve

Mesfushori boshnjak Miralem Pjaniq beson se Juventusi me Cristiano Ronaldon mund ta fitojë Ligën e Kampionëve. "Në Juventus ne luajmë gjithmonë për të fituar kompeticione. Në katër vjetët e fundit ne kemi arritur dy finale të Ligës së Kampionëve, dhe kjo nuk është diçka e lehtë për t'u bërë. Na duhet diçka më shumë për ta fituar këtë trofe. Ne besojmë në këtë ëndërr dhe jemi në rrugën e duhur. Ronaldo është çelësi ynë. Ai ka fituar shumë dhe është një ndër më të mirët. Duke e pasur atë në skuadër na ofron diçka ekstra. Jam shumë i lumtur që qëndrova. Objektivi im është të vazhdoj të fitoj me klubin tim", ka thënë Pjaniqi.



| | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Autor: GAZMEND MORINA | GJELBËRIM | SËMUNDJE E FËMIJËVE, QË SHFAQET ME SHTREMBËR-IMIN E ESHTRAVE | | GUR I ÇMUAR, SHUMË I FORTË E ME NGJYRË TË KUQE / SOJI | ALBERT ROHAN | LLOJ DRURI | | ZBAVITËS, TËRHEQËS | BASHKËTING. | SHKURTABIQ | KOPJON |
| | | | | | | QË SILLET A VEPRON ME ASHPËRSI, I VRAZHDË | | | | | | | PATRIOTI RRUSTEMI / PJESA E ERRËT E DITËS | | | | |
| | | | | | | RRJET I NGATËRRUAR KALIMESH E SHTIGJESH | | | | | | | | | AZEM MAKSUTAJ / ISMET RAMUSHI | | |
| | | | | | | SKUADËR | | | | | LLOJ HELMI LUFTE (shq.) / SHTET NË AZI (pashq.) | | | | | | |
| | | | | | | RI FILLOJ | | | | | | LLOJ LETRASH FATI / SILIC | | | | | |
| | | | | | | IGLI TARE | | | RROTULLOJ RRETH VETES; SJELL RROTULL | SHKENCËTARI NJUTON / NEVOJË FIZIOLOGJIKE | | | | | MARIGONA OSAJ / EMËR MASHKULLI ANGLEZ | | |
| | | | | | | SHTET FEDERAL NË SHBA | | | | | | | MJET UDHËTIMI / AKTORI ANGLEZ ORLANDO (shqip.) | | | | |
| | | | | | | | SHTRËNGIMI QË I BËHET DIKUJT PËR DIÇKA / KULLAT E XHAMIVE | | | | | AKTORJA & MANEKINIA AMERIKANE JESSICA / KOMPOZITORI KOCI (shq.) | | | | | MJET LUFTE |
| | HEROI NË FOTO | PËRMBLEDHJE KRIJIMESH LETRARE OSE PUNIMESH SHKENCORE QË BOTOHET SI VJETAR | LUTJE, DUA (mysl.) | | PASURIA E PATUNDSHME QË SILLTE TË ARDHURA / REGJISORI QOSJA | ZILI, INAT | | | | | ALUMIN, VOLT, AMPER / U ARRATISA | | | | | ZANORE / BOSHT | |
| LAGJE NË SHKUP (shq.) | | | | | | SHALQI (shq.) / ZANORE | | | | | | | | SHEGË / I QËND-RUESHËM NDAJ SËMUNDJEVE | | | |
| QYTET NË SHQIPËRI / NJËSI E MADHE USHTARAKE | | | | | | | | LYERJA ME LLAK / AKTORI HOLLIVUDIAN BRED ... | | | | | | | DY BASHKË-TINGËLLORE / KOCKA | | |
| | | | | | | VËLLAI I MADH / KOTUR | | | | ALASKA, LUIZANA / ZEZAK, NEGRI | | | VËLLIMI, SASIA / GRUP AKUMULAT-ORËSH (shq.) | | | | |
| SHTET NË AFRIKË | | | | | KLUB I YNI BASKETBOLLI / I THAJ | | | | | | EMËR MASHKULLI MYSLIMAN / QELESHE (shq.) | | | | | ILAZ KODRA | PIRAT |
| INDIUM, ELEKTRON | | | | IRNOSET (bised.) / ISH FUTBOLLISTI HOLANDEZ .... VAN DER MEJDE | | | | | DY BASHKË-TINGËLLORE / GRADË OFICERI E SHKALLËS SË PARË | | | QË I PËRKET NJË KOHE TË LASHTË / KALIBËR I TYTËS SË ARMËS | | | | | |
